



---

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR  
MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN NË TREGUN E SIGURIMEVE NË VITIN 2021

Shkup, 2022

*Raporti është përgatitur në përputhje me nenin 158-o të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve. Për hartimin e tij Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka përdorur të dhëna nga raportet të cilat subjektet ia dorëzojnë Agjencisë në përputhje me kërkesat ligjore. Për saktësinë e të dhënave përgjigjen subjektet e mbikëqyrjes.*

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJA</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>2. KORNIZA LIGJORE</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>3. MJEDISI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR</b>	<b>8</b>
<b>4. TREGU I SIGURIMEVE NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SE VERIUT</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.1. STRUKTURA E PRONËSISË	12
4.1.2. NORMA E ZHVILLIMIT	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.3. PRIMI I SHKRUAR BRUTO	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.4. STRUKTURA E PJESËMARRJES	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.5. DËMET E PAGUARA BRUTO	22
4.1.5.1 Ankesat nga të Siguruarit	24
4.1.6. FONDET DHE BURIMET E FONDEVE	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.6.1. Struktura e fondeve	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.6.2. Struktura e burimeve të fondeve	29
4.1.7. Provigjonet teknike	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.8. FONDET TË CILAT I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.9. ADEKUATSHMËRIA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.10. REZULTATI FINANCIAR NGA USHTRIMI I AKTVITETIT	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.1.10.1. Rreziqet e sektorit të sigurimeve	37
4.1.11. INDIKATORË TË SEKTORIT TË SIGURIMEVE	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.2.1. PËRFAQËSIMI NË SIGURIME	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.2.2. VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>4.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.3.1. FONDI GARANTUES I BNS	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
4.3.2. RIMBURSIMI I DËMEVE NGA FONDI GARANTUES	47

## LISTA E TABELAVE

TABELA NR. 1: INDIKATORË MË TË RËNDËSISHËM PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE .....	10
TABELA NR. 2: STRUKTURA E PRONËSISË SË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE .....	12
TABELA NR. 3: INDEKSI HERFINDAL DHE INDIKATORI CR5 I MATUR SIPAS PSHB.....	14
TABELA NR. 4: INDEKSI HERFINDAL DHE INDIKATORI CR5 I MATUR SIPAS MJETEVE.....	14
TABELA NR. 5: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMEVE .....	15
TABELA NR. 6: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT JO-JETË .....	16
TABELA NR. 7: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE TË JETËS .....	16
TABELA NR. 8: PRIMI I SHKRUAR BRUTO .....	17
TABELA NR. 9: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR SIGURIMIN E JETËS .....	20
TABELA NR. 10: STRUKTURA E INVESTIMEVE NGA SIGURIMET E JETËS UNIT-LINKED, 2021 .....	21
TABELA NR. 11: STRUKTURA E INVESTIMEVE NGA SIGURIMET E JETËS UNIT-LINKED,2020 .....	21
TABELA NR. 12: DËME TË PAGUARA SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT.....	22
TABELA NR. 13: NUMRI I DËMEVE TË PAGUARA .....	24
TABELA NR. 14: PARASHTRESA TË PARASHTRUARA NË SHOQËRITË E SIGURIMEVE NGA TË SIGURUARIT .....	25
TABELA NR. 15: PARASHTRESA TË PARASHTRUARA NË AMS NGA TË SIGURUARIT .....	26
TABELA NR. 16: STRUKTURA E MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE.....	27
TABELA NR. 17: STRUKTURA E MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JO-JETË .....	29
TABELA NR. 18: STRUKTURA E MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE TË JETËS .....	29
TABELA NR. 19: STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE .....	30
TABELA NR. 20: STRUKTURA DHE NDRYSHIMI I PROVIGJONEVE TEKNIKE BRUTO .....	30
TABELA NR. 21: MJETET QË I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE TE SHOQËRITË E SIGURIMIT JO-JETË.....	32
TABELA NR. 22: MJETET QË I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE TE SHOQËRITË E SIGURIMIT TË JETËS .....	33
TABELA NR. 23: KOEFICIENTE TEKNIKE .....	39
TABELA NR. 24: INDIKATORË FINANCIARË.....	41
TABELA NR. 25: STRUKTURA E KANALEVE TË SHITJES SË POLICAVE SIPAS PSHB-SË TË REALIZUAR .....	42
TABELA NR. 26: PJESËMARRJA NË FONDIN GARANTUES SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT.....	46
TABELA NR. 27: DËME TË PARAQITURA DHE TË PRANUARA PËR RIMBURSIM TË FONDIT GARANTUES .....	47

## LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU NR. 1:INDIKATORËT E ZHVILLIMIT TË TREGUT TË SIGURIMEVE .....	13
GRAFIKU NR. 2: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PSHB - SIGURIMET JO- JETË .....	14
GRAFIKU NR. 3: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PSHB - SIGURIMET I JETËS.....	15
GRAFIKU NR. 4: STRUKTURA E PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT .....	18
GRAFIKU NR. 5: TRENDI I PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT .....	19
GRAFIKU NR. 6: MARRËVESHJE TË LIDHURA TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE.....	22
GRAFIKU NR. 7: PJESËMARRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË DËMET E PAGUARA BRUTO.....	23
GRAFIKU NR. 8: STRUKTURA E PJESËMARRJES SË SHOQËRIVE NË MJETET E PËRGJITHSHME .....	28
GRAFIKU NR. 9: MBULIMI I PROVIGJONEVE TEKNIKE – SIGURIMI JO-JETË .....	31
GRAFIKU NR. 10: MBULIMI I PROVIGJONEVE TEKNIKE NETO – SIGURIMI I JETËS.....	32
GRAFIKU NR. 11: LËVIZJA E KAPITALIT DHE MARGJINA E NEVOJSHME E AFTËSISË PAGUESE .....	34
GRAFIKU NR. 12: STRUKTURA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE .....	34
GRAFIKU NR. 13: REZULTATI FINANCIAR NGA VEPRIMTARIA E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE.....	37
GRAFIKU NR. 14: STRUKTURA E PBSH-SË, SHOQËRI E PËRFAQËSIMIT .....	43
GRAFIKU NR. 15: STRUKTURA E PBSH-SË, SHOQËRI BROKERIMI NË SIGURIME .....	44

## 1. HYRJA

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin që vijon "AMS") është trup rregullator i pavarur në tregun e sigurimeve i cili ushtron autorizime publike të përcaktuara me Ligjin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport. AMS-ja ka për qëllim të kontribuojë në funksionimin e ligjshëm dhe efikas të tregut të sigurimeve në vend, në zhvillimin e vazhdueshëm të tij, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të siguruarve/policëmbajtësve, si edhe në avancimin e stabilitetit financiar në vend.

Gjatë vitit 2021, pavarësisht sfidave të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit, sektori vendor i sigurimeve ka ruajtur një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit dhe aftësisë paguese dhe realizoi rezultat financiar pozitiv. Me këtë, tregoi gatishmëri të mirë për t'u përballur me goditjet, për të cilën kontribuoi gjendja e mirë e sektorit para pandemisë, por edhe masat e marra nga AMS-ja si përgjigje ndaj krizës. Pandemia ndikoi në funksionimin e sektorit kryesisht përmes uljes së kërkesës së kontratave për sigurim në vitin 2020, gjë që vlente për të dy segmentet e sigurimeve, megjithatë, në vitin 2021 vërehet rimëkëmbja e sektorit dhe rritje sërishmi e kërkesës për lloje të caktuara kontratash sigurimi (Kartoni jeshil dhe Sigurimi i shëndetit në udhëtim). Rreziqet e humbjeve në investimin mbetën të kufizuara për shkak të politikës konservatore të investimeve të shoqërive të sigurimit, në instrumente më pak të rrezikshme dhe likuide dhe ekspozimit të ulët ndaj tregjeve financiare ndërkombëtare.

Në fund të vitit 2021 në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut operojnë aktivisht 16 shoqëri sigurimesh, prej të cilave 11 shoqëri ushtrojnë aktivitetin e sigurimeve jo-jetës, kurse 5 sigurime të jetës. Në sektorin e ndërmjetësisimit, në fund të vitit 2021 aktive janë 39 shoqëri brokerimi në sigurime, 12 shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe 7 banka të cilat ushtrojnë aktivitetin e përfaqësimit në sigurime.

Në vitin 2021 është realizuar primi i shkruar bruto (në tekstin që vijon "PSHB") në shumë të përgjithshme prej 11,63 miliarda denarësh, që përbën një rritje prej 15,53% në krahasim me PSHB-në e realizuar në vitin 2020 (2020: 10,07 miliarda denarë). Në pjesën e sigurimit jo-jetës është realizuar PSHB në shumë prej 9,63 miliarda denarësh (2020: 8.32 miliarda denarë), përkatësisht rritje prej 15,56% në krahasim me vitin 2020. Njëkohësisht, te sigurimi i jetës është realizuar PSHB-ja në shumë prej 2,00 miliarda denarësh (2020: 1,74 miliarda denarë), që përbën një rritje prej 15,01%.

Shoqëritë e Sigurimeve më 31.12.2021 disponojnë me mjete në shumë prej 28.51 miliarda denarësh, që shënojnë rritje prej 11.06 % në krahasim me vitin e kaluar (2020: 25,67 miliarda denarë). Kapitali i përgjithshëm i llogaritur i shoqërive të sigurimeve shënon rritje prej 3,22 % në krahasim me vitin 2020 dhe arrin 7.24 miliarda denarë. Margjina e solvencës ose aftësisë paguese, si indikator kryesor për vlerësim të stabilitetit të sektorit të sigurimeve është 1.89 miliarda denarë, kështu që kapitali i sektorit të sigurimeve është 3.8 herë mbi nivelin e margjinës së aftësisë paguese

Gjatë vitit 2021, sektori i sigurimeve realizoi fitim me vlerë prej 132,94 milionë denarësh. Ndërkaq, shoqëritë e sigurimeve jo-jetës realizuan fitim prej 53,44 milionë denarësh, kurse, shoqëritë e sigurimeve të jetës realizuan fitim për tatim prej 186,89 milionë denarësh

Në fushën e normativës ligjore në vitin 2021 janë miratuar 3 ndryshime të akteve nënligjore aktuale dhe 2 akteve të reja nënligjore. Gjithashtu, në mars të vitit 2022, Këshilli i Ekspertëve të AMS-së mori

qëndrim për t'u rekomanduar shoqërive të sigurimeve që të përmbahen nga shpërndarja dhe pagesa e dividendës nga fitimi i realizuar në vitin 2021, përkatësisht atë ta shpërndajnë në rritje të rezervave të sigurisë dhe rezervave të tjera të shoqërisë, derisa ekziston pasiguri lidhur me kohëzgjatjen e krizës dhe vlerësimin të rrezikut mbi gjendjen dhe stabilitetin e tyre financiar.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/02, 98/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 112/11, 188/13, 30/14, 43/14, 112/14, 153/15, 92/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 31/20), Ligji për Sigurim të Detyrueshëm në Transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14 dhe 145/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), Ligji për Sigurime Vullnetare Shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/12 dhe 192/15), Ligji për Pagim të Pensioneve dhe Kompensimeve Pensionale në Fushën e Sigurimit Pensional me Financimit Kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 147/15 dhe 30/16) dhe Ligji për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120/18 dhe 317/2020 janë korniza ligjore themelore e cila i normativizon kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të ndërmjetësimit në sigurime dhe zbatimin e mbikëqyrjes së aktivitetit të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit të sigurimeve dhe shoqërive të përfaqësimit në sigurime.

Kornizën më të gjerë ligjore e përfaqësojnë Ligji për Marrëdhënie Obligative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09 dhe 123/13) në pjesën që lidhet me marrëveshjet e sigurimeve dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16 dhe 61/16, 64/18 dhe 120/18).

**Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve** i inkorporon parimet dhe standardet e sigurimeve të Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), si dhe direktivat për sigurime të Bashkimit Evropian (BE). Me këtë ligj normativizohet themelimi dhe puna e shoqërive të sigurimeve, menaxhimi me rreziqet, roli i aktuarëve të autorizuar, mbajtja e regjistrave të biznesit dhe raporteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, përfaqësimi dhe ndërmjetësimi në sigurimet, mbikëqyrja e shoqërive të sigurimeve, puna e AMS-së, zbatimi i mbikëqyrjes dhe procedura për marrjen e aktvendimeve nga AMS-ja, bashkëpunimi me organet dhe trupat mbikëqyrëse të BE-së, si dhe dispozitat ndëshkuese apo kundërvajtëse.

Sigurimi i Detyrueshëm në Transport rregullohet me **Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm në Transport**, i cili i rregullon kontratat e sigurimit të detyrueshëm, shumat minimale të sigurimit, afatet e raportimit dhe kompensimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve, përcaktimin e së drejtës për ndërmjetësim (mediacion), kompetencat e Fondit të Garancisë, ndryshimin e mënyrës së përcaktimit të tarifave të primit përmes funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Autopërgjegjësisë dhe dispozitat ndëshkuese për shoqëritë e sigurimeve dhe Byronë Nacionale të Sigurimeve. Ligji gjithashtu përcakton detyrimet që shoqëritë e sigurimeve të caktojnë përfaqësues të autorizuar për dëmet jashtë vendit në mënyrë që viktimat e aksidenteve rrugore të kenë akses të lehtë dhe të shpejtë në paraqitjen e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga automjetet e vendit jashtë tij, si dhe të krijojnë një Shërbim për Kompensim të Dëmeve, si garanci për viktimat e aksidenteve rrugore jashtë vendit, ku edhe nëse shoferi përgjegjës drejtonte një automjet të pasiguruar, dëmi do të trajtohet dhe paguhet në kohën e duhur. Disa nga këto dispozita tashmë kanë hyrë në fuqi, ndërsa disa të tjera do të hyjnë në fuqi nga momenti i anëtarësimit të plotë të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Me **Ligjin për sigurim vullnetar shëndetësor** jepet mundësi ligjore dhe hapet një fushë e gjerë veprimi për shoqëritë e sigurimeve për oferta të pakove të shërbimeve shëndetësore të cilat janë përfshirë tashmë me sistemin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor. Sigurimi shtesë shëndetësor

siguron mbulim të shpenzimeve në emër të pjesëmarrjes me mjete personale për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore nga sigurimi i detyruar shëndetësor (participim), në përputhje me dispozitat e sigurimit të detyruar shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore. Sigurimi privat shëndetësor mundëson mbulim të shpenzimeve për përdorim të shërbimeve shëndetësore për standard më të lartë të shërbimeve shëndetësore të cilat dalin nga sigurimi i detyruar shëndetësor, shpenzimet për mbulim të shërbimeve shëndetësore të përdorura në veprimtari shtesë, si dhe për përdorim të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore jashtë rrejtës të institucioneve shëndetësore ku kryhet veprimtaria shëndetësore dhe te personat juridikë të cilët kryejnë përpunim, dhënie dhe servisim të mjeteve ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse.

**Me Ligjin për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga fusha e sigurimit pensional me financim kapital** përfundoi normativizimi i sigurimit kapital financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me rregullim të fazës së deakumulimit, përkatësisht me këtë Ligj rregullohen pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë dhe kompensimet e pensionit nga shtylla e tretë. Në ligj në mënyrë të hollësishme rregullohen llojet e pagesave të pensioneve në shtyllën e dytë (tërheqje të programuara, anuitete të përjetshme dhe kombinimi i tyre), llojet e pagesave të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete, pagesa të njëfishta dhe të shumëfishta), karakteristika dhe rregulla për lloje të ndryshme të pagesave dhe mënyra dhe procedura e fitimit të së drejtës së pensionit në bazë të moshës, pension invalidi dhe pension familjar nga shtylla e dytë, si dhe procedurë për fitimin e së drejtës të kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Në këtë Ligj rregullohet edhe se cilat institucione do të mund të bëjnë pagim të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë - shoqëritë pensionale dhe shoqëritë për sigurim të jetës. Gjithashtu, për shkak të transparencës më të madhe të përzgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimit të pensionit nga shtylla e tretë, u vendos Sistem elektronik i centralizuar i kotacionit nëpërmjet të cilit do të dorëzohen kërkesa për kotacione për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve.

**Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit** përcakton kompetencën e AMS-së për të zbatuar mbikëqyrje në tregun e sigurimeve i cili i nënshtrohet rregullimit të këtij Ligji, veçanërisht në pjesën e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**Ligji për masat kufizuese** u cakton obligime shtesë subjekteve përgjegjëse për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pastrimit të parave në drejtim të identifikimit dhe ndërmarrjes së veprimeve (masave financiare) ndaj personave për të cilët janë vendosur masa kufizuese nga BE-ja ose Kombet e Bashkuara. “Masat financiare” sipas nenit 5 të Ligjit për masat kufizuese përkufizohen si “ndalim i përdorimit, bartjes, konvertimit, transferimit ose lloj tjetër i disponimit të pronës, ndalim i vënies në disponim të çdo pasurie, drejtpërdrejt ose tërthorazi, si dhe ndalim i krijimit ose vazhdimin të marrëdhënies afariste.

### **3. MJEDISI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR**

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2021 Prodhimi bruto vendor real (në tekstin vijues “PBV”) shënoi rritje prej 4%. Gjegjësisht, pas rënies së thellë prej 6,1% në vitin 2020 si

rezultat i krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Kovid-19, gjatë vitit 2021 është vërejtur rimëkëmbje graduale e ekonomisë vendore.

Ndërkaq, rritja ekonomike në vitin 2021 është si rezultat i disa faktorëve, siç janë përshtatja graduale e sjelljes dhe shprehive të subjekteve në kushtet e pandemisë, rihapja e ekonomive dhe aplikimi i masave të synuara dhe më pak kufizuese për t'u përballur me pandeminë, si dhe masat e ndërmarra për të mbështetur ekonominë. Sipas komponentëve, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2021 është si rezultat tërësisht i kontributit pozitiv të kërkesës vendore, në kushtet e rritjes vjetore dhe kontributit pozitiv në të gjitha kategoritë e saj (konsumi personal, investimet bruto dhe konsumi publik), ndërsa komponenti i eksportit neto ka kontribut negativ, në kushtet e rritjes më të lartë të importit në krahasim me rritjen e eksportit. Në anën e prodhimit, rritja u nxit nga shërbimet (tregtia, transporti, turizmi, informacionet dhe komunikimet dhe patundshmëritë), ndërsa industria u përball me ndërprerje në zinxhirët e furnizimit dhe, në fund të vitit, me efektet negative të krizës energjetike, dhe ndërtimi pësoi rënie të mëtejshme.

Në vitin 2021, norma mesatare e inflacionit ishte 3.2%, që paraqet përsheptim mesatar krahasuar me realizimin në vitin 2020, kur inflacioni ishte 1.2%. Në përgjithësi, kjo rritje e çmimeve vendore gjatë vitit reflekton ndryshimet në çmimet e produkteve primare në bursat botërore, e cila lidhet me ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit global dhe rihapjen e ekonomive, efektet bartëse të ndryshimeve administrative dhe rregullatore të vitit të kaluar, si dhe nga disa faktorë specifikë për krizën pandemike, dhe në kushte të lehtësimit të masave kufizuese nga fundi i tremujorit të dytë të vitit. Pra, presionet e çmimeve gjatë vitit 2021 kanë ardhur kryesisht nga faktorët e anës së ofertës. E analizuar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të konsumit u përsheptua gjatë vitit dhe një rritje pak më e lartë e çmimeve me bazë vjetore u shënuar në gjysmën e dytë të vitit.

**Sistemi financiar i Republikës së Maqedonisë** karakterizohet me strukturën e thjeshtë relative. Sistemi bankar, e pastaj fondet e detyrueshme pensionale private dhe shoqëritë e sigurimeve, kanë pjesëmarrje më të lartë në aktivin e sistemit financiar dhe pothuajse vazhdimisht kontribuojnë më së shumti për rritjen e tij absolute. Pjesëmarrja e sektorit të sigurimeve (shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e përfaqësimit në sigurime dhe shoqëritë e brokerimit të sigurimeve) në strukturën e përgjithshme financiare në vitin 2020 është 3,83%<sup>1</sup>. Segmentet e tjera të sistemit financiar, në veçanti dhe bashkërisht, edhe më tutje përfshijnë një pjesë shumë të vogël të aktivitetit të përgjithshëm të sektorit financiar, megjithëse një pjesë e tyre pothuajse shënojnë vazhdimisht rritje relativisht dinamike. Edhe krahas rritjes së vazhdueshme të sistemit financiar, analiza krahasuese e niveleve të ndërmjetësimit financiar me vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore tregon rritje modeste të sektorit financiar vendor. Segmentet më të mëdha dhe më të rëndësishme të sistemit financiar janë kryesisht në pronësi të aksionarëve të huaj. Struktura e pronësisë dhe përqendrimi në segmente të veçanta të sistemit financiar nuk shënojnë ndryshime më të konsiderueshme në vitin 2021.

**Lidhshmëria ndërsektoriale** e segmenteve të veçanta institucionale të sistemit financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mundësia për kalimin e rreziqeve nga njëri segment në tjetrin janë në nivel të ulët. Arsyet për këtë janë struktura e thjeshtë e sistemit financiar, lidhshmëria e vogël e ndërsjellë e aktiviteteve të segmenteve të veçanta dhe mungesa e instrumenteve dhe shërbimeve më të ndërlikuara financiare. Stabiliteti i sistemit financiar është i kushtëzuar nga

<sup>1</sup> Raporti i stabilitetit financiar për vitin 2020, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

stabiliteti i sektorit bankar si segmenti i tij kryesor, ku janë përqendruar kursimet e sektorit jofinanciar dhe institucioneve të tjera financiare. Lidhshmëria e pronësisë ndërmjet institucioneve të veçanta nga sistemi financiar është në korniza mesatare dhe nuk paraqet burim varësie ndërmjet segmenteve të veçanta<sup>2</sup>.

Në kushtet e zhvillimit ende të dobët të tregjeve financiare dhe alternativave të kufizuara për investimin dhe rritjen e mjeteve të subjekteve ekonomike, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të institucioneve financiare jobankare janë plasuar në depozita bankare. Gjithashtu, kreditë e bankave të aprovuara për institucionet financiare jobankare paraqesin edhe një tjetër kanal të mundshëm të varësisë në sistemin financiar. Kërkesat dhe detyrimet ndërbankare janë edhe një tjetër kanal i mundshëm për varësi në sistemin financiar, megjithëse është ende me rëndësi relativisht të vogël. Sigurimin bankar, përkatësisht bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe shoqërive të sigurimit bazuar në marrëveshje përfaqësimi në sigurimin, në vitin 2021 e kanë aplikuar 7 banka (njëjtë si vitin paraprak) dhe është edhe një shembull i lidhjes ndërsektorale. Ekziston një lidhje e qenësishme midis sektorit të lizingut dhe sektorit të sigurimeve për shkak të detyrimit rregullator për të siguruar mjetin me lizing të ndonjë shoqëri të sigurimit (përveç nëse nuk është caktuar ndryshe në marrëveshjen e lizingut). Gjithashtu, oferta e a.q. produktet unit-linked të cilat paraqesin kombinim të sigurimit të jetës me investim në grup, përkatësisht sigurimit të jetës ku rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari, sugjerojnë për lidhshmërinë e këtij lloji të sigurimit me lëvizjet e tregjeve financiare, përkatësisht realizimet e fondeve investuese. Lidhja e pronësisë që ekziston ndërmjet institucioneve të veçanta financiare është një tjetër kanal potencial i ndërvarësisë dhe kalimit eventual të rreziqeve nga njëri segment i sistemit financiar në tjetrin.

Gjatë analizës dhe krahasimit të indikatorëve për shkallën e **zhvillimit të tregut vendor për sigurim me tregjet e rajonit** dhe më gjerë, mund të konkludohet se është në nivele përafërisht të ngjashme me vendet e rajonit më të afërt, por larg nën nivelin e zhvillimit të mesatares së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo, para së gjithash, është si rezultat i faktit që shoqëritë e sigurimeve të ne nuk janë përfshirë në fazën e akumulimit të mjeteve nga kontributet e paguara nga sigurimi pensional me financim kapital, dhe ende janë në fazë të hershme të zhvillimit dhe ofertës së pakove të shërbimeve në fushën e sigurimit shëndetësor vullnetar. Kjo padyshim ndikon për të pasur vëllim shumë më të vogël të primeve vjetore në këto produkte krahasuar me të njëjtat në tregjet e zhvilluara të sigurimit.

**TABELA NR. 1:** Indikatorët më të rëndësishëm për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitin 2021

	PBV, çmime aktuale (miliarda euro)	PBV për banor, çmime aktuale (euro)	Primi i shkruar bruto (milione euro)	Norma e penetrimit (% në PBV)	Norma e dendësisë (Euro/banor)
Shqipëria	15,65	5.499	160	1,02%	56
Bosnja dhe Hercegovina	18,95	5.445	418	2,21	120
Bullgaria	67,87	9.872	1.660	2,45%	241
Kroacia	57,40	14.229	1.559	2,72%	386
Çekia	246,47	23.030	7.225	2,93%	675
Estonia	30,66	23.052	486	1,59%	366

<sup>2</sup> Raporti i stabilitetit financiar për vitin 2020, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Hungaria	149,18	15.330	3.603	2,42%	370
Kosova	7,64	4.251	119	1,56%	66
Letonia	32,92	17.390	849	2,58%	449
Lituania	53,33	19.833	1.040	1,88%	373
Maqedonia	11,74	5.673	189	1,61%	91
Mali i Zi	4,91	7.900	99	2,01%	159
Polonia	565,97	14.957	15.050	2,66%	398
Rumania	238,35	12.332	2.878	1,21%	149
Serbia	53,31	7.759	1.026	1,92%	149
Sllovakia	97,12	18	1.848	1,90%	338
Sllovenia	52,02	24.666	2.609	5,02%	1.237
<b>Europa Qendrore dhe Lindore - Gjithsej/Mesatare</b>	<b>1.705,48</b>	<b>14.235</b>	<b>40.819</b>	<b>2,39%</b>	<b>341</b>

*Burimi: XPRIMM, Raporti vjetor për vitin 2021*

Nga 17 shtete në Europën Qendrore dhe Lindore sipas indikatorit shkalla e penetrimit, Maqedonia gjendet në vendin e 13-të sipas zhvillimit të tregut të sigurimit (para Shqipërisë, Kosovës, Rumanisë dhe Estonisë), ndërsa sipas indikatorit shkalla e dendësisë në vendin e 15-të (para Shqipërisë dhe Kosovës).

## 4. TREGU I SIGURIMEVE NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SE VERIUT

### 4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2020, në tregun e sigurimeve operuan 16 shoqëri, nga të cilat 5 shoqëri sigurimesh operojnë me sigurime të jetës, ndërsa 11 të tjerat operojnë me sigurime jo-jetë. Vetëm një shoqëri, përveç aktiviteteve të sigurimit jo-jetë, ka licencë për të ushtruar veprimtari të risigurimit.

Shoqëritë e sigurimeve në fund të vitit 2021 kanë 1.803 punonjës, gjë që paraqet ulje prej 3,89% të numrit të fuqisë së angazhuar punëtore krahasuar me vitin 2020 (2020: 1.876).

#### 4.1.1. Struktura e pronësisë

Shoqëritë e sigurimeve janë në pronësi dominuese të personave të huaj juridikë në sektorin financiar (75,67%), të cilët janë pjesërisht ose tërësisht të pranishëm në 14 nga gjithsej 16 shoqëritë e sigurimeve në treg (Tabela nr.2). Në këtë mënyrë, 12 shoqëri të sigurimeve janë pjesë e grupeve të sigurimeve me seli në vendet anëtare të BE-së, ndërsa dy shoqëri të sigurimeve janë plotësisht në pronësi të investuesve vendorë.

**TABELA NR. 2:** Struktura e pronësisë së shoqërive të sigurimeve (për qindje)

	2021	2020	2019
<b>1. Aksionerë të huaj</b>	<b>75,67%</b>	<b>80,11%</b>	<b>79,51%</b>
1.1. Persona fizikë	0,52%	0,33%	0,04%
1.2. Persona juridikë jofinanciarë	0,00%	0,00%	0,00%
1.3. Institucione financiare	75,16%	79,78%	79,46%
<b>2. Aksionarë vendorë</b>	<b>24,30%</b>	<b>19,86%</b>	<b>20,46%</b>
2.1. Persona fizikë	4,26%	4,88%	4,97%
2.2. Persona fizikë jofinanciarë	0,54%	0,61%	0,91%
2.3. Institucione financiare	19,49%	14,37%	14,58%
<b>3. Shteti</b>	<b>0,03%</b>	<b>0,03%</b>	<b>0,03%</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>


Burimi: AMS

#### 4.1.2. Norma e zhvillimit

Indikatorët themelorë me të cilët matet norma e zhvillimit të tregut të sigurimeve janë norma e penetrimit/depërtimit dhe norma e dendësisë<sup>3</sup>. Të dhënat për nivelin e penetrimit të sigurimeve në vitin 2021 tregojnë se PSHB-ja e përgjithshme në vend merr pjesë me 1.61% në prodhimin bruto vendor, që është për 0,09% më shumë se viti i kaluar (2020: 1.52%). Ndërsa norma e dendësisë për vitin 2021 është 6.332 denarë për banor që shënon rritje prej 30,60% në raport me vitin e kaluar (Grafiku nr. 1).

<sup>3</sup>Norma e penetrimit llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe prodhimit bruto vendor, kurse norma e dendësisë llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe numrit të banorëve në vend.

**GRAFIKU NR. 1:** Indikatorët e zhvillimit të tregut të sigurimeve (milione denarë; boshti i djathtë – përqindja)



Burimi: AMS, AMS, Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ministria e Financave

Sektori i sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me përqendrim të ulët i cili është parakusht për konkurrencën funksionale të tregut. Indeksi Herfindal, i llogaritur përmes PSHB-së në vitin 2020 është 747,46 (2020: 769,56 ). Një rezultat i ngjashëm tregohet nga matja e indeksit përmes fondeve/aseteve të shoqërive të sigurimeve në 812,88 në vitin 2021 (2020: 838,02)<sup>4</sup>.

Analizuar sipas grupeve të sigurimeve, përqendrim më i lartë është i pranishëm në sigurimet e jetës, për shkak të numrit të vogël të shoqërive në këtë fushë. Në shoqëritë e sigurimeve të jetës indeksi Herfindal, i matur sipas PSHB-së, është 2.407,60 (2020: 2.788,97), ndërsa i matur sipas fondeve/aseteve të shoqërisë, është 2.960,76 (2020: 3.077,21 ).

Në sigurimin jo-jetë indikatorët tregojnë përqendrim të ulët, me ç’rast matja përmes indeksit Herfindal sipas PSHB-së në vitin 2020 është 986,51 (2020: 1.003,06 ) dhe tregon një rënie krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa i njëjti indikator i matur përmes fondeve është 1.035,56 (2020: 1.070,59).

Indikator i CR5<sup>5</sup>, i matur përmes pjesëmarrjes në PSHB, te shoqëritë e sigurimeve jo-jetë, në vitin 2021 pati rënie me 58,97% (2020: 56,86% ).

Në vijim janë tabelat që tregojnë lëvizjet e indeksit Herfindal dhe indikatorët e përqendrimit të pesë shoqërive të para të sigurimeve (CR5):

<sup>4</sup> Indeksi Herfindal llogaritet sipas formulës

$$HI = \sum_{i=1}^n (S)_i^2$$

ku S është pjesa e secilës shoqëri të sigurimeve në totalin e aktiveve (primi i shkruar bruto) i sektorit të sigurimeve, dhe n është numri i përgjithshëm i institucioneve në segmentin përkatës. Kur indeksi lëviz në intervalin prej 1,000 njësive në 1,800 njësi, niveli i përqendrimit të sektorit të sigurimeve konsiderohet i pranueshëm

<sup>5</sup>Indikator i CR5 është pjesëmarrja e 5 shoqërive të sigurimeve me pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e përgjithshme.

**TABELA NR. 3:** Indeksi Herfindal dhe indikator CR5 i matur sipas PSHB-së

PSHB	2021		2020		2019	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	747,46	52,57%	769,56	47,03%	792,42	47,87%
Jo-jetë	986,51	58,97%	1.003,06	56,86%	1.020,43	57,99%
Jetë	2.407,60	100,00%	2.788,97	100,00%	3.157,74	100,00%


Burimi: AMS

**TABELA NR. 4:** Indeksi Herfindal dhe indikator CR5 i matur sipas fondeve

Pasuritë	2021		2020		2019	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	812,88	46,55%	838,02	54,15%	821,71	53,50%
Jo-jetë	1.035,56	56,23%	1.070,59	60,69%	1.058,79	60,64%
Jetë	2.960,76	100,00%	3.077,21	100,00%	3.083,30	100,00%

Burimi: AMS


Në fund të vitit 2021, në fushën e përqendrimit të tregut në pjesën e sigurimeve jo-jetë, 4 shoqëri të sigurimeve e kalojnë pragun e pjesëmarrjes me mbi 10% në totalin e PSHB-së. Kështu që, në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut asnjë shoqëri nuk e kalon pragun e mbi 20% të pjesëmarrjes në treg (Grafiku nr. 2)

**GRAFIKU NR. 2:** Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkuar Bruto në vitin 2021, në grupin e sigurimeve jo-jetë (përqindje)

Burimi: AMS

Në grupin e sigurimit të jetës, krahas rritjes së dukshme mbimesatare të primeve të shkuara në vitin 2021 të tri nga pesë shoqëritë të sigurimit të jetës, ende pjesëmarrje dominuese kanë dy shoqëritë e sigurimit të jetës (Grafiku nr. 3)

**GRAFIKU NR. 3:** Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkruar Bruto në vitin 2021, në grupin e sigurimeve të jetës (përqindje)



Burimi: AMS

#### 4.1.3. Primi i Shkruar Bruto

Primi i Shkruar Bruto në sigurime dhe risigurime tek shoqëritë e sigurimeve jo - jetë përfshin të gjitha shumatat e primit që janë dakorduar (polica) në periudhën aktuale të kontabilitetit, pavarësisht nëse ato i referohen plotësisht ose pjesërisht periudhës së ardhshme, ndërsa në sigurimin e jetës primi i përgjithshëm i policës përfshin të gjitha primit e paguara deri në fund të periudhës së kontabilitetit.

Në vitin 2021 PSHB u realizua në shumën totale prej 11,63 miliardë denarësh (Tabela nr. 5), që paraqet rritje prej 15,54% krahasuar me PSHB-në të realizuar në vitin 2020 (2020: 10,06 miliardë denarë).

**TABELA NR. 5:** Primi i shkruar bruto sipas klasave të sigurimeve (mijë denarë)

Klasat e sigurimeve	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
	2021	2020	21/20	2021	2020
01. Sigurimi i aksidenteve	647.100	748.395	-13,53%	5,56%	7,43%
02. Sigurimi shëndetësor	405.009	273.649	48,00%	3,48%	2,72%
03. Sigurimi i mjeteve motorike-kasko	890.288	823.735	8,08%	7,66%	8,18%
05. Sigurimi i mjeteve ajrore-kasko	88.367	9.084	872,78%	0,76%	0,09%
06. Sigurimi i mjeteve të lundrimit-kasko	1.673	1.104	51,54%	0,01%	0,01%
07. Sigurimi i transportit të mallrave-kargo	90.412	84.696	6,75%	0,78%	0,84%
08. Sigurimi i pasurisë nga zjarri	758.584	768.207	-1,25%	6,52%	7,63%
09. Sigurime të tjera të pasurisë	1.408.342	1.092.265	28,94%	12,11%	10,85%
10. Autopërgjegjësia	4.836.286	4.136.297	16,92%	41,59%	41,09%
11. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të mjeteve ajrore	19.106	6.787	181,51%	0,16%	0,07%
12. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të objekteve/mjeteve të lundrimit	3.418	2.709	26,17%	0,03%	0,03%
13. Sigurime të tjera të përgjegjësisë	252.424	211.970	19,08%	2,17%	2,11%
14. Kredi	9.525	25.158	-62,14%	0,08%	0,25%
15. Sigurime të garancive	269	536	-49,81%	0,00%	0,01%
16. Sigurimi i humbjeve financiare	69.169	64.478	7,28%	0,59%	0,64%
17. Sigurimi mbrojtjes ligjore	5	8	-37,50%	0,00%	0,00%
18. Sigurimi i asistencës turistike	147.949	76.325	93,84%	1,27%	0,76%
19. Sigurimi i jetës	1.618.576	1.438.761	12,50%	13,92%	14,29%
20. Sigurimi martesë-lindje	0	0	/	0,00%	/
21. Sigurimi i jetës kur rreziku i investimit merret përsipër nga i siguruari	383.198	301.742	27,00%	3,29%	3,00%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>11.629.700</b>	<b>10.065.906</b>	<b>15,54%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>
<b>GJITHSEJ JO-JETË</b>	<b>9.627.926</b>	<b>8.325.403</b>	<b>15,65%</b>	<b>82,79%</b>	<b>82,71%</b>
<b>GJITHSEJ JETË</b>	<b>2.001.774</b>	<b>1.740.503</b>	<b>15,01%</b>	<b>17,21%</b>	<b>17,29%</b>

Burimi:AMS

Trendi pozitiv është i pranishëm në të dy segmentet e sigurimeve, duke pasur parasysh se në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në vlerë prej 9,63 miliardë denarë (2020: 8,32 miliardë denarë), ose 82.71% të PSHB-së totale të sektorit të sigurimeve dhe paraqet ulje prej 15,65% krahasuar me vitin 2019. Gjatë vitit 2021, nuk u realizua asnjë prim i risigurimit (2020: 0).

Individualisht, krahasuar me vitin 2020, nuk u regjistrua rënie në PSHB te asnjë shoqëri të sigurimeve jo -jetë (Tabela nr. 6).

**TABELA NR. 6:** Primi i Shkruar Bruto sipas shoqërive të sigurimit jo-jetë (mijë denarë)

Nr.	Shoqëri sigurimesh	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2021	2020	21/20	2021	2020
1	Triglav	1.332.869	1.231.614	8,22%	13,84%	14,79%
2	Eurolink	1.124.298	963.579	16,68%	11,68%	11,57%
3	Unika	1.023.456	827.544	23,67%	10,63%	9,94%
4	Halk	991.893	821.730	20,71%	10,30%	9,87%
5	Sava	941.572	848.398	10,98%	9,78%	10,19%
6	Maqedonia	911.313	862.860	5,62%	9,47%	10,36%
7	Viner	848.348	712.129	19,13%	8,81%	8,55%
8	Euroins	807.699	726.996	11,10%	8,39%	8,73%
9	Kroacia Jo-Jetë	670.262	460.756	45,47%	6,96%	5,53%
10	Osiguritelna polisa	658.248	602.980	9,17%	6,84%	7,24%
11	Garve Jo-Jetë	317.968	266.817	19,17%	3,30%	3,20%
	<b>GJITHSEJ JO-JETË</b>	<b>9.627.926</b>	<b>8.325.403</b>	<b>15,65%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>

Burimi: AMS

Në pjesën e sigurimit të jetës, që paraqet 17.29% të PSHB-së së përgjithshme të sektorit të sigurimeve, është realizuar PSHB në një vlerë prej 2.00 miliarda denarësh (2020: 1,74 miliarda denarë), që përbën rritje prej 15,01% në raport me vitin 2020.

Individualisht në krahasim me vitin 2020, rritja e PSHB-së është vërejtur te katër shoqëri të sigurimeve të jetës (Tabela nr. 7).

**TABELA NR. 7:** Primi i Shkruar Bruto sipas shoqërive të sigurimeve të jetës (mijë denarë)

	Shoqëri sigurimesh	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2021	2020	21/20	2021	2020
1	Kroacia Jetë	688.282	654.532	5,16%	34,38%	37,61%
2	Grave	518.447	534.483	-3,00%	25,90%	30,71%
3	Viner Jetë	348.206	305.663	13,92%	17,39%	17,56%
4	Unika Jetë	247.416	182.689	35,43%	12,36%	10,50%
5	Triglav Jetë	199.423	63.136	215,86%	9,96%	3,63%
	<b>GJITHSEJ JETË</b>	<b>2.001.774</b>	<b>1.740.503</b>	<b>15,01%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>

Burimi: AMS

Një nga indikatorët më adekuatë për volumin e aktiviteteve të kryera të shoqërive të sigurimeve është analiza e volumit të aktiviteteve të kryera sipas klasave të ndryshme të sigurimit. Pasqyra e tillë tabelore mundëson analizë të shpërndarjes së primit për klasa të ndryshme të sigurimit sipas shoqërive të sigurimit, përkatësisht i jep përgjigje pyetjes në cilat produkte sigurimi janë specializuar shoqëritë e aktuara. Në këtë mënyrë, përmes të të dhënave për PSHB-në sipas klasave të sigurimit, në mënyrë plotësuese është paraqitur struktura e tregut e të gjitha shoqërive të sigurimeve në vitin 2021 (Tabela nr. 8).

**TABELA NR. 8: Primi i shkruar bruto për periudhën 01.01.2021- 31.12.2021 (mijë denarë)**

Klasa e sigurimi	Jo-jetë											Gjithsej
	Makedonija	Triglav	Sava	Evroins	Eurolink	Viner	Grawe	Unika	Osiguritelna Polisa	Halk	Kroacija	
01. Sigurimi i aksidenteve	63.619	85.861	81.238	22.511	81.661	46.006	15.758	53.182	38.112	73.836	85.316	647.100
02. Sigurimi shëndetësor	7.332	86.500	36.834	15.632	104.012	1.966	0	18.920	127	73.702	59.984	405.009
03. Mjetet motorike kasko	60.822	157.892	152.921	57.569	77.567	56.487	7.870	82.112	88.559	87.529	60.960	890.288
04. Mjetet hekurudhore kasko	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
05. Mjetet fluturuese kasko	0	0	0	0	78.100	7.300	0	0	767	2.200	0	88.367
06. Mjetet lundruese kasko	6	302	519	11	185	94	0	98	217	241	0	1.673
07. Kargo	20.978	34.261	3.104	10.993	2.729	1.018	0	8.959	1.898	3.671	2.801	90.412
08. Prona nga zjarri dhe rreziqe tjera	149.445	82.928	61.534	69.679	200.840	14.231	3.300	32.257	36.198	56.171	52.001	758.584
09. Pronat tjera	293.491	220.215	113.932	224.552	99.100	86.540	1.104	145.442	12.461	190.826	20.679	1.408.342
10. AP (gjithsej)	259.017	536.428	451.445	395.570	384.668	605.325	286.078	623.730	453.458	471.770	368.797	4.836.286
11. Përgjegjësia nga mjete fluturuese	0	0	0	0	6.876	9.492	0	0	1.230	1.508	0	19.106
12. Përgjegjësia nga mjete lundruese	187	475	874	77	496	214	0	345	480	267	3	3.418
13. Përgjegjësia e përgjithshme	37.793	37.821	11.213	5.014	63.173	13.249	599	42.162	13.398	21.504	6.498	252.424
14. Kredia	1.570	4.585	881	131	0	0	0	0	0	-68	2.426	9.525
15. Garancia	3	61	8	62	9	2	0	0	16	108	0	269
16. Humbjet financiare	10.165	49.409	2.406	414	274	0	0	6.273	0	172	56	69.169
17. Mbrojtja juridike	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	3	5
18. Ndihma turistike	6.885	36.131	24.663	5.482	24.608	6.424	3.259	9.976	11.327	8.456	10.738	147.949
<b>Gjithsej</b>	<b>911.313</b>	<b>1.332.869</b>	<b>941.572</b>	<b>807.699</b>	<b>1.124.298</b>	<b>848.348</b>	<b>317.968</b>	<b>1.023.456</b>	<b>658.248</b>	<b>991.893</b>	<b>670.262</b>	<b>9.627.926</b>

Klasa e sigurimit	Jetë					Gjithsej
	Kroacia	Grave	Viner	Unika	Triglav	
19. Jeta	592.373	497.035	173.606	163.166	192.396	1.618.576
20. Martesa apo lindja	0	0	0	0	0	0
21. Sigurimi i jetës kur rreziku investues bie mbi të siguruarit	95.909	21.412	174.600	84.250	7.027	383.198
<b>Gjithsej</b>	<b>688.282</b>	<b>518.447</b>	<b>348.206</b>	<b>247.416</b>	<b>199.423</b>	<b>2.001.774</b>


**Gjithsej: 11.629.700**

Burimi: AMS

#### 4.1.4. Struktura e pjesëmarrjes

Në PSHB-në e përgjithshme pjesëmarrje më të rëndësishme ka sigurimi i mjeteve motorike me 49.25% (2020:49,27%), që përbëhet nga sigurimi dominues nga auto-përgjegjësia (AO), që merr pjesë me 41.59% (2020: 41,09%) dhe nga sigurimi vullnetar i mjeteve motorike (kasko) që merr pjesë me 7,66% (2020: 8,18%). Vend të rëndësishëm në strukturën e PSHB-së zë sigurimi i pronës me 18.63% (2020: 18,48%), sigurimi i jetës me pjesëmarrje prej 13.92% (2020: 17,29%) dhe sigurimi nga pasojat në rast fatkeqësie (aksidenti) merr pjesë me 5,56% (2020: 7,43%). Struktura sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit, si dhe krahasimi me vitin 2020 është paraqitur në Grafikon nr. 4.

**GRAFIKU NR. 4:** Struktura e Primit të Shkruar Bruto sipas klasave të sigurimit (përqindje)



Burimi: AMS

Rritje e PSHB-së prej 16,92 % krahasuar me vitin 2020 është vërejtur në klasën e sigurimeve të autopërgjegjësive (AP) me prim të përgjithshëm në shumë prej 4.84 miliardë denarësh (2020: 4,14 miliardë denarë) ndërsa është rritur edhe numri i marrëveshjeve të lidhura prej 19,53%. Te sigurimi kasko i mjeteve motorike me prim të përgjithshëm në shumë prej 890,28 milionë denarësh (2020: 823,73 milionë denarë) dhe rritje të njëkohshme prej 6,04% në numrin e marrëveshjeve të lidhura.

Te sigurimi i pronës vërehet zmadhim prej 16,47% me PSHB 2,17 miliardë denarësh (2020:1,86 miliardë denarë), gjatë zmadhimit të njëkohshëm të numrit prej 10,47% të numrit të marrëveshjeve të lidhura. Duke analizuar sipas grupeve, te personat fizikë kemi rritje prej 10,84% të marrëveshjeve të lidhura, të shoqëruar me rritje prej 33,59% të PSHB-së, kurse te personat juridikë kemi rritje prej 9.33 % të marrëveshjeve të lidhura dhe rritje prej 10,05% të PSHB-së.


Në suazat e sigurimit të pronës, te sigurimi bujqësor vërehet rritje prej 2.85% të numrit të marrëveshjeve të lidhura, si dhe zmadhim prej 13.33% të PSHB-së së realizuar për sigurim bujqësor që është 546,85 milionë denarë (2020: PSHB prej 482,53 milionë denarësh).

Në vitin 2021, vërehet rritje shumë e madhe në shitjen e sigurimeve shëndetësore me lidhje të 18.235 marrëveshjeve për sigurim shëndetësor me PSHB të përgjithshme prej 405,00 milionë denarë (2020: 273,65, milionë denarë) që në krahasim me vitin 2020 përbën rritje për 70,33% të numrit të marrëveshjeve të lidhura, përkatësisht rritje për 48,00% të PSHB-së të përgjithshme.

Ulje të PBSH-së ka te sigurimi në rast fatkeqësie prej 13.53% krahasuar me vitin 2020 me prime të përgjithshme në shumë prej 647,10 milionë denarë (2020: 748,39 milionë denarë), e sa i përket numrit të marrëveshjeve të lidhura ka rritje prej 13.39%. Njëra prej shkaqeve për uljen e PBSH-së në këtë klasë të sigurimit është ajo që rreziku i vdekjes si pasojë e sëmundjes që ishte e përfshirë më parë në marrëveshjet kolektive për sigurim në rast fatkeqësie, duke filluar nga 1.1.2021 u transferua në policat e sigurimit të jetës, e në bazë të sqarimit të dhënë nga AMS-ja.

Në Grafikon nr. 5 është treguar trendi i PSHB-së sipas klasave të sigurimit.

**GRAFIKU NR. 5:** Trendi i Primit të Shkruar Bruto sipas klasave të sigurimit (milionë denarë; boshti i djathtë – përqindjet)



*Burimi: AMS*

Te sigurimi i jetës është realizuar PBSH në shumë prej 2.00 miliardë denarësh (2020: 1,74 miliardë denarë, që paraqet rritje prej 15,01% , kështu që sigurimi i jetës merr pjesë me 17,21% në PBSH-në e përgjithshme të sektorit të sigurimit.

Te sigurimi tradicional i jetës (klasa 19) është realizuar trend pozitiv te PBSH-ja që është 1,61 miliardë denarë (2020:1,44) që paraqet rritje prej 11,80% me rritje të madhe dhe të numrit të marrëveshjeve të sapolidhura të jetës prej 184,43% dhe atë kryesisht te lloji i marrëveshjeve të ardhshme për sigurim të jetës (vdekjes). Lidhur me këto kontrata, vlen të theksohet se ato më së shpeshti lidhen nga ana e kredikërkuësve –personave fizik nga bankat, dhe kanali më i shpeshtë i shitjes janë pikërisht bankat. Te sigurimi i jetës kur rreziku investues merret përsipër nga i siguruari (klasa 21) vazhdon trendi vjetor i rritjes prej 27.00% me PBSH të realizuar prej 383,20 milionë denarësh (2020: 301,74 milionë denarë).

Në tabelën vijuese është paraqitur struktura e primit të shkruar bruto për sigurim të jetës në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020.

**TABELA NR. 9:** Primi i shkruar bruto për sigurimin e jetës, në mijëra denarë

	Klasa	Gjithsej 2020	Gjithsej 2021	Ndryshimi 21/20	Pjesëmarrja 2020	Pjesëmarrja 2021
<b>Sigurimi i jetës</b>	<b>19</b>	<b>1.438.762</b>	<b>1.618.576</b>	<b>12,50%</b>	<b>82,70%</b>	<b>80,86%</b>
Sigurimi themelor total i jetës		1.323.491	1.495.115	12,97%	76,00%	74,69%
Sigurimi i përzier		766.219	786.856	2,69%	44,00%	39,31%
Vdekje (në të ardhmen)		181.009	330.446	82,56%	10,40%	16,51%
Mbijetesa		151.433	157.325	3,89%	8,70%	7,86%
Sigurimi i përzier me TBS		220.919	216.595	-1,96%	12,70%	10,82%
Vdekje (përjetësisht)		3.911	3.893	-0,46%	0,20%	0,19%
Sigurim të përgjithshme shtesë		115.271	122.052	5,88%	6,60%	6,10%
Sigurimi i fatkeqësisë (vdekje)		36.491	34.926	-4,29%	2,10%	1,74%
Sigurimi fatkeqësisë (invaliditet)		63.892	69.205	8,32%	3,70%	3,46%
Sigurimi shëndetësor (të tjera)		14.888	17.921	20,37%	0,90%	0,90%
Sigurimi i përgjithshëm i qirasë			1.409		0,00%	0,07%
<b>Sigurimi i jetës kur rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari</b>	<b>21</b>	<b>301.742</b>	<b>383.198</b>	<b>27,00%</b>	<b>17,30%</b>	<b>19,14%</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>1.740.504</b>	<b>2.001.774</b>	<b>15,01%</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>

Burimi: AMS

Të dhënat mbi primet e shkruara bruto të zbërthyera sipas llojeve të produkteve, përkatësisht rreziqeve që mbulohen me këto produkte, janë një nga indikatorët që konfirmojnë tezën se zvogëlohet pjesëmarrja e sigurimeve tradicionale, të a.q. të përziera, të jetës që kanë komponent kursimi, për llogari të rritjes së a.q. sigurime të rrezikut të jetës që mbulojnë vetëm rrezikun e vdekjes, përkatësisht rritje të marrëveshjeve për sigurim të jetës ku mjetet e investuara nga primet riorientohen në blerjen e pjesëmarrësve të emetuara nga fondet investuese dhe ku i siguruari e bart rrezikun e investimeve të shoqërive që administrojnë këto fonde investimi.

Çmimi me të cilin shoqëria e sigurimit i blen aksionet nga fondi investues në emër dhe për llogari të të siguruarit janë çmimet e tregut, përkatësisht çmimet e bursës në periudhën kur i siguruari e paguan primin e dakorduar të shoqërisë së sigurimit. Kontratat janë afatgjata, përkatësisht i siguruari shpesh paguan primin në një periudhë disavjeçare. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit ndaj të siguruarit varet nga vlera e tregut të aksioneve në datën në të cilën lind detyrimi i shoqërisë ndaj të siguruarit. Nëse blerjet e aksioneve në emër dhe për llogari të të siguruarit janë bërë në periudha kur vlerat e tregut të pjesëmarrjeve kanë qenë të ulëta, dhe nëse detyrimi i dakorduar i shoqërisë së sigurimit ndaj të siguruarit ka ndodhur në një periudhë kohore kur vlerat e tregut të pjesëmarrjeve janë dukshëm më të larta, i siguruari do të realizojë fitim, përkatësisht do të fitojë shumë më tepër mjete në para sesa nga totali i investimeve, përkatësisht arkëtimeve të primeve. Dhe anasjelltas, nëse në momentin e arkëtimeve të primeve ndaj shoqërisë së sigurimit vlera e pjesëmarrjes ka qenë e lartë dhe në momentin e pagesës së detyrimeve të dakorduara ndaj të siguruarit vlera e pjesëmarrjeve është e ulët, i siguruari duhet të dijë se do të fitojë më pak se sa që ka investuar, përkatësisht do të ketë humbje. Prandaj, për këto produkte thuhet se i siguruari bart rrezikun e ndryshimit të vlerës së tregut të mjeteve të investuara.

Struktura e investimeve të mjeteve të arkëtuara nga a.q. sigurime të jetës unit-linked, sipas shoqërive të sigurimit dhe në fonde të veçanta investuese më datë 31.12.2021 dhe më datë 31.12.2020 është paraqitur në tabelat në vijim:

**TABELA NR. 10:** Struktura e investimeve të mjeteve nga sigurimi i jetës unit-linked më datë 31.12.2021

Shoqëria e sigurimeve	Prodhimi	Emri i fondit investues	Sasia	Vlera neto e pjesëmarrjes ose aksionit	Vlera e kontabilitetit në denarë	Rezerva e e veçantë në denarë
Viner Jetë	Llajf Invest	VFP Premium Invest	2.846.625	150,6171	428.750.338	428.750.338
	Futura	Generali Investments	5.474	156,4300	856.370	856.370
Grave	Grave Invest	VFP fond menaxhment – Grave Glllobal	89.350	138,2728	12.354.694	12.354.694
Kroacia Jetë	Fleksi Invest	VFP PREMIUM INVEST	269.033	150,6171	40.520.919	43.797.112
	Fleksi Invest	VFP 100% BOND	11.447	118,1835	1.352.886	1.483.880
	Kro Invest	KB Publikum Fond i Balancuar	588.056	191,5161	112.622.252	113.057.085
	Garant Invest	Generali Top Brendovi	123.497	156,4288	19.318.504	19.551.005
Trigllav Jetë	Unit link	VFP Premium Invest	213	150,6171	32.136	32.136
	Unit link	Generali Top Brends	24.826	156,4288	3.883.447	3.883.447
	Unit link	KB Publikum Fond i Balancuar	14.270	191,5161	2.733.016	2.733.016
Unika Jetë	Unit link	Ilirika Evropa Juglindore	221.994	62,5485	13.885.400	13.885.400
	Unit link	Ilirika Glllobal Tregu Rritës	121.932	76,2685	9.299.572	9.299.572
	Unit link	VFP Premium Invest	359.438	150,6171	54.137.563	54.137.563
	Unit link	VFP 100% Bond	10.386	118,1835	1.227.471	1.227.471
	Unit link	Generali Top Brendovi	31.633	156,4288	4.948.380	4.948.380

Burimi AMS

**TABELA NR. 11:** Struktura e investimeve të mjeteve nga sigurimet e jetës unit-linked më datë 31.12.2020


Shoqëria e sigurimeve	Prodhimi	Emri i fondit investues	Sasia	Vlera neto e pjesëmarrjes ose aksionit	Vlera e kontabilitetit në denarë	Rezerva e e veçantë në denarë
Viner Jetë	Llajf Invest	VFP Premium Invest	2.146.752	120,5953	258.888.085	258.888.085
	Futura	Generali Investments	2.337	137,1756	320.645	320.645
Grave	Grave Invest	VFP fond menaxhment – Grave Glllobal	34.279	111,6961	3.828.885	3.828.885
Kroacia Jetë	Fleksi Invest	VFP PREMIUM INVEST	162.265	120,5953	19.568.435	21.279.501
	Fleksi Invest	VFP 100% BOND	6.583	115,7358	761.891	929.445
	Kro Invest	KB Publikum Fond i Balancuar	433.598	171,7137	74.454.674	74.485.503
	Garant Invest	Generali Top Brendovi	15.208	137,1756	2.086.220	2.115.520

<b>Trigllav Jetë</b>	Unit link	VFP Premium Invest	132	120,5953	15.865	15.865
<b>Unika Jetë</b>	Unit link	Iirika Evropa Juglindore	156.435	54,4878	8.523.805	8.523.805
	Unit link	Iirika Glloball Tregu Rritës	63.367	72,4432	4.590.521	4.590.521
	Unit link	VFP Premium Invest	160.722	120,5953	19.382.297	19.382.297
	Unit link	VFP 100% Bond	4.090	115,7358	473.304	473.304
	Unit link	Generali Top Brendovi	5.903	137,1756	809.699	809.699

Burimi: AMS

Gjatë vitit 2021, shoqëritë e sigurimeve kanë lidhur 1,533,706 marrëveshje, që paraqet rritje prej 31,49% krahasuar me vitin 2020 kur janë lidhur 1,166,439 marrëveshje. Nga numri i përgjithshëm i marrëveshjeve të lidhura, 1,473,386 polica janë në kuadër të sigurimit jo-jetë, që paraqet rritje prej 28,82% krahasuar me numrin e policave në vitin 2020 (2020: 1,143,766 polica), ndërsa 60,320 janë policat e sigurimit të jetës, pra rritje prej 166.04% krahasuar me vitin 2020. Ndryshimi i numrit të marrëveshjeve të lidhura sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit është paraqitur në grafikon nr. 6.

**GRAFIKU NR. 6:** Marrëveshje të lidhura te shoqëritë e sigurimeve (boshti i majtë; boshti i djathtë – ndryshimi vjetor në përqindje)



Burimi: AMS

#### 4.1.5. Dëmet e paguara bruto

Në vitin 2021, shoqëritë e sigurimeve kanë paguar shuma bruto të dëmeve prej 4,66 miliardë denarë (TABELA NR. 12). Krahasuar me vitin 2020, dëmet bruto të paguara janë rritur për 16,45% (2020: 4,00 miliardë denarë). Pjesëmarrja e risigurimit në dëmet e paguara bruto është 14.58%.

**TABELA NR. 12:** Dëmet e paguara sipas klasave të sigurimit (mijëra denarë)

Klasa të sigurimit	2021	2020	Ndryshimi	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2020
Autopërgjegjësia	2.102.153	1.880.406	11,79%	45,1%	46,9%
Sigurimi i pronës	709.851	630.200	12,64%	15,2%	15,7%
Sigurimi i jetës	565.318	424.472	33,18%	12,1%	10,6%
Sigurimi i mjeteve motorike (kasko)	507.183	483.812	4,83%	10,9%	12,1%
Sigurimi në rast fatkeqësie	434.078	396.887	9,37%	9,3%	9,9%
Sigurimi shëndetësor	211.276	105.990	99,34%	4,5%	2,6%
Klasa të tjera – jo-jetë	45.542	10.669	326,86%	1,0%	0,3%
Sigurimi i shëndetit në udhëtim	40.278	48.110	-16,28%	0,9%	1,2%
Jetë (pjesëmarrje)	29.712	12.419	139,25%	0,6%	0,3%
Përgjegjësi e përgjithshme	18.831	12.399	51,88%	0,4%	0,3%
<b>Gjithsej</b>	<b>4.664.222</b>	<b>4.005.364</b>	<b>16,45%</b>	<b>100,0%</b>	<b>100,0%</b>


Burimi: AMS

Në strukturën e dëmeve të paguara bruto, pjesëmarrje më të madhe kanë dëmet për autopërgjegjësi me 45,07%, pastaj vijojnë dëmet për sigurime të pronës me pjesëmarrje prej 15,22%, dëmet e paguara për sigurim të jetës me 12,76%, dëmet e paguara për sigurime kasko të mjeteve motorike me 10,87%, dhe sigurimi i personave nga pasojat nga fatkeqësia me 9,3% nga dëmet e paguara të përgjithshme.

Në pjesën e sigurimit të pronës, vend të rëndësishëm zë sigurimi bujqësor me pjesëmarrje prej 50,29% dhe me dëme të përgjithshme të paguara prej 316.85 milionë denarësh.

Në Grafikon nr. 7 është paraqitur pjesëmarrja individuale e shoqërive të sigurimeve në shumën e përgjithshme të dëmeve të paguara për vitin 2021

**GRAFIKU NR. 7:** Pjesëmarrja e shoqërive të sigurimit në dëmet e paguara bruto në vitin 2021 (milionë denarë), veçmas për jo-jetë dhe jetë



Burimi: AMS

Nëse analizohet numri i dëmeve të paguara sipas klasave të veçanta të sigurimit, mund të vërehet se në vitin 2021 ka një rritje të dukshme të numrit të dëmeve të paguara në bazë të sigurimit shëndetësor vullnetar, përkatësisht disa kompani kanë paguar më shumë dëme në këtë klasë të sigurimit në krahasim me klasën e sigurimit të autopërgjegjësive. Pavarësisht frekuencës së lartë të dëmeve në këtë klasë të sigurimit, shumica mesatare e dëmeve të paguara është shumë më e ulët në krahasim me të njëjtën në klasën më të përfaqësuar të sigurimit të përgjegjësive automobilistike. Ky është indikator se numri i madh i raportimeve nga të siguruarit në policat e sigurimit shëndetësor ndaj shoqërive të sigurimit kanë qenë për kompensim të shumave të siguruar që kanë kushtuar më pak se 10.000 denarë për rast individual. Për krahasim, dëmi mesatar i paguar në bazë të sigurimit nga përgjegjësia automobilistike në vitin 2021 ka qenë 70.419 denarë. (TABELA NR. 13)

**TABELA NR. 13:** Numri i dëmeve të paguara

Klasa të sigurimit	2021	2020	Ndryshimi
Autopërgjegjësia	29.852	25.370	17,67%
Sigurimi shëndetësor	23.057	11.710	96,90%
Sigurimi i pronës	8.976	9.439	-4,91%
Sigurimi i mjeteve motorike (kasko)	7.843	7.634	2,74%
Sigurimi në rast fatkeqësie	7.324	7.587	-3,47%
Sigurimi i jetës	3.760	2.803	34,14%
Sigurimi i shëndetit gjatë udhëtimit	1.819	2.005	-9,28%
Përgjegjësi e përgjithshme	371	380	-2,37%
Jetë (pjesëmarrje)	242	154	57,14%
Klasa të tjera – jo-jetë	94	75	25,33%
<b>Gjithsej jo-jetë</b>	<b>79.336</b>	<b>64.200</b>	<b>23,58%</b>
<b>Gjithsej jetë</b>	<b>4.002</b>	<b>2.957</b>	<b>35,34%</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>83.338</b>	<b>67.157</b>	<b>24,09%</b>

Burimi: AMS

#### 4.1.5.1 Parashtrësia/ankesa nga të siguruarit

Në rast kur i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit konsideron se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet dispozitave të marrëveshjes së sigurimit, i njëjti mund të dorëzojë parashtrësia/ankesë në:

- 1) Njësinë organizative përkatëse kompetente për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve kontraktuese në kuadër të shoqërisë së sigurimeve;
- 2) Shërbimin e auditimit të brendshëm në shoqërinë e sigurimeve;
- 3) Organizatën për mbrojtjen e konsumatorëve dhe
- 4) Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Në vitin 2021 në shoqëritë e sigurimeve janë paraqitur 5282 ankesa, që është 38,34% më shumë krahasuar me vitin 2020 (2020: 3818 parashtrësia të paraqitura). Nga totali i ankesave të paraqitura, 26,85% (2020: 28,23%) janë zgjidhur pozitivisht, pra në favor të të siguruarit/shfrytëzuesit të sigurimit dhe 60,85% (2020: 63,44%) janë me përgjigje negative.

Në TABELËN NR.14 janë paraqitur të dhëna për numrin dhe rezultatin e ankesave të paraqitura dhe të zgjidhura nga shoqëritë e sigurimeve. Siç shihet nga tabela, rreth 6 shoqëri të sigurimeve jo-jetë shmangen nga mesatarja e tregut për sa i përket numrit të parashtresave të paraqitura (mesatarja e tregut për vitin 2021 është 464 parashtresa të pranuar për shoqëri të sigurimeve jo-jetë), ndërsa 2 shoqëri të sigurimeve të jetës tejkalojnë mesataren e tregut që është 36 parashtresa të pranuar për shoqëri të sigurimeve të jetës.

**TABELA NR. 14:** Parashtresa të parashtruara nga të siguruarit në shoqëritë e sigurimeve në vitin 2021

2021	Numri i parashtresave	Numri i parashtresave të zgjidhura pozitivisht	Numri i parashtresave të zgjidhura negativisht	Numri i parashtresave të zgjidhura pjesërisht	Numri i parashtresave që janë në proces të vendimmarrjes	Numri i parashtresave për të cilat është vepruar në afatin ligjor	Numri i parashtresave për të cilat nuk është vepruar në afatin ligjor
Trigllav	732	5	411	316	0	732	0
Viner	650	285	332	0	33	617	0
Halk	618	210	391	0	17	601	0
Unika	592	222	355	0	15	577	0
Sava	524	182	275	13	54	474	0
Osiguritelna polisa	465	162	294	0	9	456	0
Eurolink	427	26	271	89	41	386	0
Kroacia Jo-jetë	329	77	226	15	11	318	0
Grave Jo-jetë	307	111	196	0	0	307	0
Maqedonia	288	64	224	0	0	288	0
Evroins	170	0	145	25	0	170	0
Kroacia Jetë	82	39	37	0	6	82	0
Grave	53	18	32	0	3	53	0
Viner Jetë	27	10	16	0	1	27	0
Unika Jetë	12	5	7	0	0	12	0
Trigllav Jetë	6	2	2	0	0	6	0
<b>Gjithsej</b>	<b>5.282</b>	<b>1.418</b>	<b>3.214</b>	<b>458</b>	<b>190</b>	<b>5.106</b>	<b>0</b>

*Burime: AMS*

Të siguruarit, shfrytëzuesit e sigurimeve dhe palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë të paraqesin parashtresë në AMS në lidhje me punën e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, shoqërive të brokerimit të sigurimeve, shoqërive të përfaqësimit në sigurime, përfaqësuesve në sigurime dhe Byrosë Nacionale të Sigurimeve, por vetëm nëse i është adresuar më parë me shkrim subjektit dhe nuk janë të kënaqur me përgjigjen ose nëse subjekti nuk ka vendosur për parashtresën dhe nuk e ka njoftuar me shkrim parashtruesin e saj brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita kur e ka pranuar.

Në vitin 2021 në AMS janë parashtruar 206 parashtresa/ankesa, që paraqet rritje prej 134,09% krahasuar me vitin 2020 kur janë parashtruar vetëm 88 parashtresa. 20.39% (2020: 20.45%) nga gjithsej parashtresat e parashtruara në AMS janë zgjidhur në favor të parashtruesit të parashtresës, ndërsa 56.80% (2020: 60.23%) janë zgjidhur negativisht. Nga gjithsej parashtresat e parashtruara, 44,17% u referohen veprimeve sipas marrëveshjeve të sigurimit për përgjegjësi automobilistike, 15,05% për sigurim në rast fatkeqësie, 10,19% për sigurimin e pronës dhe pjesa tjetër u referohet marrëveshjeve të sigurimit nga klasat e tjera të sigurimit.

Në Tabelën nr. 15 janë paraqitur të dhënat për numrin dhe rezultatin e parashtrësive të parashtruara në AMS sipas subjekteve të sigurimit.

**TABELA NR. 15:** Parashtrësia të parashtruara nga të siguruarit në AMS në vitin 2021

Emri i subjektit	Numri i parashtrësive	Numri i parashtrësive të zgjidhura pozitivisht	Numri i parashtrësive të zgjidhura negativisht	Numri i parashtrësive që janë në proces të vendimmarrjes	Numri i parashtrësive të tërhequra	Numri i parashtrësive të parashtruara pa bazë të veprimit	
Halk	22	6	11	2	3	22	
Grave Jo-Jetë	21	8	6	2	5		
Unika Jo-Jetë	21	4	15	1	1		
Trigllav	18	1	16	1	0		
Viner Jo-Jetë	16	8	8	0	0		
Eurolink	14	2	12	0	0		
Euroins	13	1	11	0	1		
Osiguritelna polisa	13	4	7	2	0		
Kroacia Jetë	12	3	8	1	0		
Sava	10	1	7	2	0		
Kroacija Jo-jetë	9	2	7	0	0		
Maqedonia	4	0	3	0	1		
Grave	4	0	4	0	0		
Viner Jetë	3	1	1	1	0		
CH Osiguritelten Broker	2	0	1	0	1		
Trigllav Jetë	1	0	0	1	0		
Byroja Nacionale e Sigurimit	1	1	0	0	0		
<b>Gjithsej</b>	<b>206</b>	<b>42</b>	<b>117</b>	<b>13</b>	<b>12</b>		<b>22</b>

*Burimi: AMS*

Arsyet më të shpeshta të parashtrimit të parashtrësive në AMS, e në lidhje me punën e subjekteve të sigurimit, janë: problemet me zbatimin e Raportit Evropian, pakënaqësia me shumën e dëmit, praktika e ndryshme gjyqësore, marrëveshjet e kontestuara jashtëgjyqësore, mungesa e kritereve të vlerësimit të dëmit jomaterial, problemet gjatë lidhjes/përtëritjes së marrëveshjes së sigurimit, komunikimi i pamjaftueshëm për dëmin me të dëmtuarit, mosshpjegimi i kushteve në të cilat lidhet marrëveshja e sigurimit nga përfaqësuesit, etj.

#### 4.1.6. Fondet dhe burimet e fondeve

##### 4.1.6.1. Struktura e fondeve

Vlera e fondeve të shoqërive të sigurimeve më 31.12.2021 është 28,51 miliardë denarë dhe është më e lartë për 11,06% krahasuar me fondet e përgjithshme të shoqërive të sigurimit në vitin 2020 (TABELA NR. 16).

Pjesëmarrje më të madhe prej 72,89% në strukturën e fondeve të shoqërive të sigurimeve kanë investimet (2020: 74,44%), dhe janë rritur me 8,75% krahasuar me fondet e investuara në vitin 2020. Në kuadër të kontributeve pjesëmarrje më të dukshme prej 93.10% zë kategoria e investimeve të tjera financiare dhe ka një rritje prej 9.50% krahasuar me vitin paraprak. Kjo kategori përfshin: investimet financiare të disponueshme për shitje (51.16%), depozitat në banka, debitë dhe plasmane të tjera

(30.736%), investimet financiare që ruhen deri në maturim (13.26%) dhe investimet financiare për tregtim (4.82%). Kategoria tjetër më e rëndësishme janë investimet në truall, objekte ndërtimi dhe mjete të tjera materiale (5,52%), dhe ndërsa shënojnë rënie prej 3,49% krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu pjesë e investimeve janë edhe investimet financiare në grupin – filiale, shoqëritë e lidhura dhe entitetet e bashkëkontrolluara, të cilat marrin pjesë me 1.38% në investimet e përgjithshme dhe kanë një rënie prej 0.96%.

**TABELA NR. 16:** Struktura e fondeve të shoqërive të sigurimeve (mijëra denarë)

	31.12.2021	Pjesëmarrje	31.12.2020	Pjesëmarrja	Dinamika 21/20
Fonde jomateriale	67.890	0,24%	74.013	0,29%	-8,27%
Investime	20.783.974	72,89%	19.111.645	74,44%	8,75%
Pjesë për bashkësigurime dhe risigurime në rezervat teknike bruto	2.179.248	7,64%	1.712.094	6,67%	27,29%
Investimet financiare ku i siguruari e merr përsipër rrezikun investues (marrëveshje për sigurim)	705.923	2,48%	393.704	1,53%	79,30%
Mjete tatimore të prolonguara dhe aktuale	22.156	0,08%	14.664	0,06%	51,10%
Të arkëtueshme	3.220.278	11,29%	3.004.606	11,70%	7,18%
Asete të tjera	664.406	2,33%	563.415	2,19%	17,92%
Kufizime aktive të përkohshme	868.640	3,05%	799.961	3,12%	8,59%
Fonde joaktuale të cilat ruhen për shitje dhe aktivitetet joaktuale	0	0,00%	0	0,00%	0,00%
<b>GJITHSEJ MJETE</b>	<b>28.512.515</b>	<b>100,00%</b>	<b>25.674.102</b>	<b>100,00%</b>	<b>11,06%</b>

*Burimi: AMS*


Në vijim sipas rëndësisë, me pjesëmarrje prej 11.29% në strukturën e fondeve, janë të arkëtueshmet dhe ato shënojnë rritje prej 7,18% në raport me të arkëtueshmet në vitin 2020 (2020: 11,70%). Në suazat e të arkëtueshmeve futen edhe të arkëtueshmet për aktivitetet e drejtpërdrejta të sigurimeve (ku janë përfshirë të arkëtueshmet nga të siguruarit, të arkëtueshmet nga ndërmjetësuesit dhe të arkëtueshmet e tjera të aktiviteve të drejtpërdrejta në sigurim), të arkëtueshmet e veprimtarive në bashkësigurim dhe risigurim dhe të arkëtueshmet e tjera. Pjesëmarrje më të madhe prej 77,31% në të arkëtueshmet, kanë të arkëtueshmet për aktivitete të drejtpërdrejta të sigurimit në shumë prej 2,49 miliarda denarësh dhe shënojnë rritje prej 4.77% në raport me vitin 2020. Të arkëtueshmet e aktiviteve të bashkësigurimit dhe risigurimit kanë vlerë prej 112,00 milionësh denarë në krahasim me vitin 2020, si rezultat i rritjes së të arkëtueshmeve në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi. Të arkëtueshmet e tjera kanë vlerë prej 505,46 milionë denarësh (15,70% të të arkëtueshmeve të përgjithshme) dhe ato janë 3,18% më të ulëta në raport me vitin 2020.

Edhe pse me pjesëmarrje prej 2,48% në strukturën e fondeve/aseteve, rritje më të madhe relative prej 79,30% vërehet te investimet financiare të cilat i siguruari e ndërmerr rrezikun investues. Shoqëritë e sigurimit të jetës të cilat punojnë në klasën 21 (Sigurimi i jetës në rast kur rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari) kanë obligim që këto mjete, të cilat shërbejnë si mbulim të rezervës së veçantë në përputhje me nenin 94 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, t'i investojnë në pjesët e fondeve të hapura investuese për të cilët është pajtuar i siguruari gjatë lidhjes së marrëveshjes, përkatësisht gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktuese, e që janë regjistruar në Regjistrin e Fondeve Investuese në

Republikën e Maqedonisë së Veriut. Struktura e këtyre investimeve në fonde të veçanta më 31.12.2021 është paraqitur në tabelën nr. 10.

Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve është dhënë në Grafikon nr. 8.

**GRAFIKU NR. 8:** Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve në vitin 2021 (milionë denarë), veçmas për jetë dhe jo-jetë



*Burimi:* AMS

Nëse analizojmë strukturën e mjeteve nga shoqëritë e sigurimeve, mund të konkludohet se kategoria kryesore e shoqërive të sigurimeve të jetës janë investimet në letrat debitore me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare. Nga ana tjetër, shoqëritë e sigurimeve jo-jetë kanë një strukturë tjetër të fondeve, ku investimet në letrat debitore me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare përfaqësojnë gjysmën e vlerës totale të aktiveve, ndërsa gjysma tjetër përfaqësojnë të arkëtueshmet, pjesë e provigjoneve teknike bruto të transferuara në risigurime, pasuritë e paluajtshme dhe fondet e tjera materiale dhe jomateriale, investimet në aksione në fondet e investimeve të hapura, afatet aktive, investimet në aksione, si dhe investimet në fondin e garancisë të Byrosë Nacionale të Sigurimeve.

Vlera e kategorive individuale të mjeteve dhe përqindja e pjesëmarrjes në totalin e mjeteve, në ditën e fundit të vitit 2021 dhe 2020, për segmentin e sigurimeve jo-jetë dhe sigurimeve të jetës janë paraqitur në tabelat nr. 17 dhe 18.

**TABELA NR. 17:** Struktura e fondeve të shoqërive të sigurimeve jo-jetë (mijëra denarë)

Kategoria e fondeve	31.12.2021	Pjesëmarrje	31.12.2020	Pjesëmarrje
Letra shtetërore me vlerë	5.033.432	27,85%	4.246.559	25,88%
Depozita në banka dhe në para	4.539.366	25,11%	4.408.140	26,86%
Të arkëtueshme	2.893.352	16,01%	2.690.344	16,39%
Provigjone teknike – pjesë e risigurimeve	2.044.254	11,31%	1.589.433	9,69%
Patundshmëri dhe mjete jomateriale	1.266.565	7,01%	1.330.083	8,11%
KAK- Kufizime kohore aktive	861.760	4,77%	791.571	4,82%
Pjesëmarrje në fondet investuese	814.619	4,51%	792.804	4,83%
Aksione	362.991	2,01%	320.368	1,95%
Pjesëmarrje në BNS	185.541	1,03%	185.742	1,13%
Të tjera	61.996	0,34%	55.213	0,34%
Obligacione-korporative	12.448	0,07%	0	0,00%
<b>Gjithsej</b>	<b>18.076.326</b>	<b>100,00%</b>	<b>16.410.256</b>	<b>100,00%</b>

Burimi: AMS

**TABELA NR. 18:** Struktura e fondeve të shoqërive të sigurimeve të jetës (mijëra denarë)

Kategoria e fondeve	31.12.2021	Pjesëmarrje	31.12.2020	Pjesëmarrje
Letra shtetërore me vlerë	6.957.234	66,66%	6.125.446	66,12%
Depozita në banka dhe në para	1.794.134	17,19%	1.995.164	21,54%
Investime financiare të cilat i siguruari e merr përsipër rrezikun investues	705.923	6,76%	393.704	4,25%
Kërkesa, hua dhe paradhënie	402.319	3,86%	386.629	4,17%
Pjesëmarrje në fondet investuese	268.755	2,58%	99.027	1,07%
Provigjone teknike – pjesa në risigurim	134.994	1,29%	122.661	1,32%
Patundshmëri dhe jomateriale	126.548	1,21%	131.330	1,42%
Aksione	37.545	0,36%	1320	0,01%
Të tjera	8.840	0,08%	8.565	0,09%
<b>Gjithsej</b>	<b>10.436.292</b>	<b>100,00%</b>	<b>9.263.846</b>	<b>100,00%</b>

Burimi AMS

#### 4.1.6.2. Struktura e burimeve të fondeve

Burimet e fondeve të shoqërive të sigurimeve në vitin 2021 shënojnë rritje prej 11,06% në raport me vitin 2020 (Tabela nr. 13).

Pjesëmarrje më të madhe prej 60,47% në strukturën e burimeve të mjeteve të shoqërive të sigurimeve kanë provigjonet teknike bruto (2020: 60,39%) dhe ato kanë një rritje prej 11,22% krahasuar me vitin e kaluar.

Kategoria tjetër, me pjesëmarrje prej 28,25% në strukturën e burimeve të mjeteve, janë kapitali dhe rezervat të cilat janë rritur me 6,84%.

Obligimet e shoqërive të sigurimeve, të cilat në strukturën e burimeve marrin pjesë me 6,20% (2020: 6,27%), shënojnë rritje prej 9,88% në raport me vitin e paraprak. Në strukturën e obligimeve, pjesëmarrje më të madhe kanë obligimet te jera (47,65%), obligimet nga aktivitetet me risigurimin dhe bashkësigurimin dhe obligimet e aktiviteteve të drejtpërdrejta të sigurimeve (5,80%).

**TABELA NR. 19:** Struktura e burimeve të fondeve të shoqërive të sigurimeve (mijëra denarë)

	31.12.2021	Pjesëmarrja	31.12.2020	Pjesëmarrja	Dinamika 21/20
Kapitali dhe rezervat	8.053.384.761	28,25%	7.537.569.778	29,36%	6,84%
Obligimet subordinare	126.842.716	0,44%	157.269.350	0,61%	-19,35%
Provigjonet teknike bruto	17.242.599.896	60,47%	15.503.358.306	60,39%	11,22%
Provigjonet teknike bruto në raport me marrëveshjet te të cilat i siguruari e merr përsipër rrezikun investues	709.997.482	2,49%	396.818.804	1,55%	78,92%
Rezerva të tjera	85.415.467	0,30%	71.440.821	0,28%	19,56%
Obligime tatimore të prolonguara dhe vijuese	61.190.277	0,21%	52.131.051	0,20%	17,38%
Obligime që dalin nga depozitat e shoqërive të sigurimeve për risigurim të cedentëve, në bazë të risigurimit	91.219.844	0,32%	86.423.741	0,34%	5,55%
Obligime	1.768.965.085	6,20%	1.609.889.585	6,27%	9,88%
Kufizime pasive të përkohshme	372.899.733	1,31%	259.200.408	1,01%	43,87%
<b>GJITHSEJ BURIME TË FONDEVE</b>	<b>28.512.515.261</b>	<b>100,00%</b>	<b>25.674.101.845</b>	<b>100,00%</b>	<b>11,06%</b>

Burimi: AMS

#### 4.1.7. Provigjonet teknike

Shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike (bruto) e shoqërive të sigurimeve që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit jo-jetë në fund të vitit 2021 është 9,79 miliardë denarë, përkatësisht 12,02% rritje në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike (bruto) të shoqërive të sigurimeve që ushtrojnë aktivitetin e sigurimeve në grupin e sigurimeve të jetës është 8,14 miliardë denarë, që paraqet rritje prej 13,78% në krahasim me vitin paraprak.

**TABELA NR. 20:** Struktura dhe ndryshimi i provigjoneve teknike (mijëra denarë)

Struktura e provigjoneve teknike	Jo-Jetë			Jetë			Gjithsej		
	2021	2020	21/20	2021	2020	21/20	2021	2020	21/20
Provigjone për dëmet	5.414.205	4.837.104	11,93%	110.541	92.127	19,99%	5.524.746	4.929.231	12,08%
Provigjone për primet e transferueshme	4.261.910	3.849.932	10,70%	40.263	35.786	12,51%	4.302.173	3.885.718	10,72%
Provigjone matematike	0	0	0,00%	7.874.043	6.909.617	13,96%	7.874.043	6.909.617	13,96%
Provigjone për bonuse dhe zbritje	42.281	46.108	-8,30%	118.990	120.252	-1,05%	161.271	166.360	-3,06%
Provigjone të tjera teknike	74.969	9.240	711,35%	0	0	0,00%	74.969	74.969	0,00%
<b>Gjithsej</b>	<b>9.793.365</b>	<b>8.742.384</b>	<b>12,02%</b>	<b>8.143.837</b>	<b>7.157.782</b>	<b>13,78%</b>	<b>17.937.202</b>	<b>15.965.895</b>	<b>12,35%</b>

Burimi: AMS


Në strukturën e provigjoneve teknike pjesëmarrje më të madhe kanë provigjonet për dëmet dhe provigjonet për primet e transferueshme, kurse te shoqëritë e sigurimeve që ushtrojnë aktivitete të sigurimeve në grupin e jetës, vendin më të rëndësishëm e zë provigjoni matematik (Tabela nr.20).

#### 4.1.1. Fondet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike

Fondet që mbulojnë provigjonet teknike janë ato fonde të shoqërisë së sigurimit që shërbejnë për të mbuluar detyrimet e ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, si dhe për të mbuluar humbjet e mundshme në lidhje me ato rreziqe që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve, për të cilat shoqëria e sigurimeve është e detyruar të ndajë fonde për të mbuluar provigjonet teknike neto. Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të investojë fonde në një vlerë të paktën të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike neto nga risigurimi, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe në përputhje me Rregulloren për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjoni matematik, si dhe vendosjen dhe kufizimin e detajuar të atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/11, 127/14, 61/16, 36/ 19 dhe 107/20).

Investimet e mjeteve që i mbulojnë provigjonet teknike te shoqëritë e sigurimeve jo-jetë, në fund të vitit 2021 janë në vlerë prej 9,24 miliarda denarësh dhe mbulonin 118.96% (2020: 118,16%) të provigjoneve të përgjithshme neto teknike. (Grafiku nr.9).

**GRAFIKU NR. 9:** Mbulimi i provigjoneve teknike neto te shoqëritë e sigurimit jo-jetë (miliona denarë; boshti i djathtë - përqindje)



Burimi: AMS

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike te shoqëritë e sigurimit jo-jetë janë shpërndarë në letra me vlerë të lëshuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (51,51%), depozita në banka (37.14%),

pjesëmarrje në fonde investuese (8,82%) dhe aksione (2,53%). Shumat dhe struktura e investimeve janë dhënë në Tabelën nr. 21.


**TABELA NR. 21:** Fondet që i mbulojnë provigjonet teknike te shoqëritë e sigurimit jo-jetë (mijëra denarë)

	2021	2020	2019
Llogari bankare dhe depozita në banka	3.430.161	3.194.914	3.345.592
Letra me vlerë shtetërore	4.758.368	4.140.434	3.977.336
Aksione	233.834	225.563	213.021
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	0	0
Fonde investuese	814.619	792.804	760.648
Të tjetra	0	98.298	0
<b>Gjithsej</b>	<b>9.236.982</b>	<b>8.452.012</b>	<b>8.296.596</b>

Burimi: AMS

Te shoqëritë që operojnë me sigurimin e jetës, investimet e fondeve nga provigjonet teknike dhe nga provigjonet matematike arrijnë vlerën 7,55 miliardë denarë dhe kanë mbulim të provigjoneve teknike neto prej 103,46% (2020: 103,28%) (GRAFIKU NR.10).

**GRAFIKU NR. 10:** Mbulimi i provigjoneve teknike neto te shoqëritë e sigurimeve të jetës (milione denarë; boshti djathtas - përqindje)



Burimi: AMS

Shoqëritë e sigurimit të jetës pjesën më të madhe të fondeve që mbulojnë provigjone matematik e shpërndajnë në letra me vlerë shtetërore të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (78,11%), depozita në banka (20,61%), fonde investuese (0,59%) dhe në instrumente të tjera financiare (0,69%). (Tabela nr.22).

**TABELA NR. 22:** Fondet që i mbulojnë provigjonet teknike, provigjonin matematik të shoqëritë e sigurimeve të jetës (mijëra denarë)

	2021	2020	2019
Llogari bankare dhe depozita në banka	1.556.360	1.653.448	1.454.971
Letra me vlerë shtetërore	5.898.243	5.116.003	4.562.433
Aksione	0	0	0
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	0	0
Fonde investuese	44.251	36.502	38.941
Të tjetra	52.464	49.892	45.512
<b>Gjithsej</b>	<b>7.551.317</b>	<b>6.855.846</b>	<b>6.101.857</b>

Burime: AMS


#### 4.1.1. Adekuatshmëria e kapitalit të shoqërive të sigurimeve

Në përputhje me nenet 75 dhe 76 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve duhet ta ruajnë vlerën e kapitalit në madhësinë e nivelit të nevojshëm të aftësisë paguese. Sipas të dhënave të dorëzuara në AMS, në fund të vitit 2021, kapitali i llogaritur i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve<sup>6</sup> kap vlerën prej 7,24 miliarda denarësh, që përbën rritje prej 3.22% krahasuar me vitin 2020. Duke e analizuar sipas grupeve të sigurimit, kapitali i shoqërive për sigurim jo-jetë është 5.433 miliarda denarë, ndërsa i shoqërive të sigurimit të jetës 1,594 miliarda denarë. Mbi 95% e kapitalit të shoqërive të sigurimit është kapital bazë, përkatësisht rrjedh nga kategoritë më cilësore të burimeve të mjeteve, pra nga kapitali aksionar i paguar nga aksionet e zakonshme të emetuara, rezervat ligjore (statutore), si dhe si fitime të akumuluar të paspërndara. Shumë e vogël është pjesëmarrja e kapitalit shtesë në kapitalin total të sektorit të sigurimeve. Kjo jep besim se gjendja financiare dhe solvenca e sektorit të sigurimeve është e mirë.

Niveli i nevojshëm i aftësisë paguese, si indikator kryesor për kapitalin me të cilin duhet doemos të disponojë sektori i sigurimit, i agreguar është 1,89% miliardë denarë (te sigurimi jo-jetë 141 miliardë denarë, ndërsa te sigurimi i jetës 483 milion denarë), me çka kapitali i sektorit të sigurimit është 3,8 herë mbi nivelin e nevojshëm të margjinës së solvencës (aftësisë paguese). Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e solvencës të shoqëria e sigurimit janë paraqitur në grafikun nr. 11.

<sup>6</sup> Rregullorja e llojeve dhe përshkrimit të paragrafëve që do të merren parasysh gjatë llogaritjeve të kapitalit të shoqërisë së sigurimeve dhe/ose risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/11, 64/11, 61/16 dhe 170/19")


**GRAFIKU NR. 11:** Lëvizja e kapitalit dhe aftësia e nevojshme paguese të shoqëritë e sigurimit (milionë denarë)



Burimi: AMS

Madje 95.67% e totalit të kapitalit të shoqërive të sigurimit jo-jetë, pra 98.94% e kapitalit total të shoqërive të sigurimit të jetës është kapitali bazë, që është indikator i cilësisë së lartë të zërave të përfshirë në llogaritjen e kapitalit total, përkatësisht gjendja financiare e shoqërive të sigurimit t’u përgjigjen rrezeve të aftësisë paguese në rrethana të paparashikueshme të tregut. (GRAFIKU NR. 12)

**GRAFIKU NR. 12:** Struktura e kapitalit të shoqërive të sigurimeve (veçmas për jo-jetë), në miliona denarë dhe në përqindje të kapitalit total



Burimi: AMS

#### 4.1.2. Rezultati financiar nga ushtrimi i aktivitetit

Gjatë vitit 2020, sektori i sigurimeve realizoi fitim në shumë prej 132,95 milionë denarësh, përkundrejt fitimit të realizuar në shumë prej 451,66 milionë denarësh në vitin 2020.

Shoqëritë e sigurimit jo-jetë realizuan fitim prej 53,44 milionë denarësh (2020: fitim prej 273,81 milionë denarësh) që del nga rezultati i gjashtë shoqërive që realizuan fitim në shumë prej 320,02 milionë denarësh dhe pesë shoqëri që realizuan humbje në shumë prej 373,47 milionë denarësh.

Shoqëritë e sigurimeve të jetës realizuan fitim prej 186,39 milionë denarësh (2020: fitim prej 177,86 milionë denarësh) që del si rezultat i katër shoqërive që realizuan fitim prej 191,62 milionë denarësh dhe një shoqëri që realizoi humbje në shumë prej 5,23 milionë denarësh.

Rritja e vëllimit të operacioneve të shoqërive të sigurimit jo-jetë, e shprehur përmes rritjes së primeve të shkruara bruto dhe dëmeve bruto të paguara, është arsyeja kryesore e përqësimit të profitabilitetit në sektorin e sigurimeve jo-jetë në vitin 2021. Gjithashtu, në përqësimin e dukshëm të rezultatit financiar të disa shoqërive të sigurimit jo-jetë ka ndikuar edhe nevoja për të harmonizuar njohjen e kontabilitetit dhe raportimin e shpenzimeve të marrjes, si dhe metodën e njohjes së kontabilitetit të korigjimeve të vlerës së të arkëtueshmeve në bazë të primeve, pas përfundimit të periudhës kalimtare të shmangieve nga rregullat e kontabilitetit të miratuara më parë.

Në segmentin e sigurimeve jo-jetë, arsyet e përqësimit të profitabilitetit janë kryesisht në anën e shpenzimeve të bilancit të suksesit. Shpenzimet e përgjithshme për shkak të dëmeve të bëra, neto nga risigurimi, i kompanive të sigurimit jo-jetë në vitin 2021 arritën në 3,59 miliardë denarë dhe shënuan rritje prej 509,41 milionë denarë ose 16,55% në krahasim me vitin 2020 (2020: 3,08 miliardë denarë). Shpenzimet e përgjithshme (neto) për realizimin e sigurimit (shpenzimet akuizitive dhe administrative) arrijnë në 3,74 miliardë denarë dhe po ashtu shënojnë rritje në krahasim me vitin 2020, gjegjësisht janë 258,55 milionë denarë ose 7,42% më të larta se shpenzimet e realizuara në vitin 2020 (2020: 3,48 miliardë denarë).

Edhe një zë në anën e shpenzimeve të përgjithshme të shoqërisë së sigurimit jo-jetë është pjesë e shkaqeve për përqësimit të profitabilitetit, e ato janë shpenzimet për shkak të harmonizimit të vlerës (korigjim i vlerës) të kërkesave në bazë të premive. Shpenzimet e përgjithshme sipas kësaj baze, të shoqërive të sigurimit jo-jetë në vitin 2021 janë 161,01 milionë denarë, ndërsa në vitin 2020, të dhënat tregojnë se industria ka realizuar të ardhura për shkak të lirimit të rezervimeve të korigjimeve të të arkëtueshme në shumë të përgjithshme prej 33,61 milionë denarë. Shkaku kryesor për këtë rritje të dukshme të këtyre shpenzimeve është fakti që nga 1.1.2021 pushuan së vlejuri dispozitat kalimtare nga Rregullorja për metodën e vlerësimit të zërave nga bilanci i gjendjes dhe përgatitja e bilanceve afariste ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 141/13 dhe 61/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 107/20) me ç'rast shoqëritë e sigurimit menjëherë duhej të pranojnë në evidencën e kontabilitetit shuma më të larta të korigjimeve të kërkesave të cilat ishin të liruar më parë nga korigjimi i vlerës së kontabilitetit (masa e përkohshme për shkak të pandemisë Covid-19).

Të ardhurat e përgjithshme të shoqërive të risigurimit jo-jetë në vitin 2021 arritën në 8,24 miliardë denarë dhe shënuan rritje prej 8,7% krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2020 (2020: 7,58 miliardë denarë).

Të ardhurat nga primet, neto nga risigurimet, janë zëri më i rëndësishëm nga të ardhurat e përgjithshme të segmentit të sigurimit jo-jetë dhe arrijnë në 7,06 miliardë denarë. Krahasuar me vitin paraprak, këto të ardhura shënuan rritje prej 494,35 milionë denarë ose 7,53%.

Të ardhurat nga investimet e shoqërive të sigurimeve jo-jetë, llogaritur si dallim ndërmjet të ardhurave të përgjithshme nga investimet dhe shpenzimeve të përgjithshme nga investimet në vitin 2021, arrijnë në 326,55 milionë denarë dhe shënojnë rritje prej 25,05% (2020: 261,13 milionë denarë), kryesisht si rezultat i fitimeve të realizuara nga shitja e instrumenteve financiare të disa shoqëri sigurimesh që tregtojnë aktivisht me instrumente financiare.

Të ardhurat e përgjithshme nga komisionet nga risiguresit në vitin 2021 arrijnë në 496,36 milionë denarë dhe shënojnë rritje prej 7,90% (2020: 460,04 milionë denarë).


Shuma e përgjithshme e të ardhurave të tjera teknike të sigurimit dhe të ardhurave të tjera nga operacionet arrijnë në 273,54 milionë denarë dhe shënojnë rritje prej 81,50 milionë denarë (2020: 192,04 milionë denarë). Në këto kategori të ardhurash zakonisht përfshihen të ardhurat e realizuara për dëmet e shërbimit, të ardhurat nga shitja e mjeteve materiale etj.

Për dallim nga segmenti i sigurimeve jo-jetë, në segmentin e sigurimeve të jetës nuk ka devijime të theksuara për sa i përket profitabilitetit, megjithëse ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e portofolit të sigurimeve dhe në pjesëmarrjet tregtare.

Të ardhurat e përgjithshme nga sigurimet e jetës në vitin 2021 janë 1.932 milionë denarë. Gjithsej shpenzimet e krijuara gjatë periudhës, si rezultat i rritjes së obligimeve nga kontratat e sigurimit të jetës, arrijnë në 1.531 milionë denarë, ose 78,6% nga të ardhurat e realizuara. Shpenzimet e përgjithshme për kryerjen e aktivitetit arritën në 585 milionë denarë, që përbën 30,3% të të ardhurave nga aktiviteti bazë. Të ardhurat nga investimet, dallimi ndërmjet të të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme nga investimet, të pesë shoqërive të sigurimit të jetës në vitin 2021 arrin në 394 milionë denarë, që paraqet gati 20,4% të të ardhurave nga sigurimi.

Vitin paraprak, të ardhurat e përgjithshme nga sigurimi i jetës arritën 1.698 milionë denarë. Shpenzimet e përgjithshme nga veprimtaria bazë arritën 1.278 milionë denarë, ose 75,3% e të ardhurave. Shpenzimet e përgjithshme 508 milionë denarë, ose 30% të të ardhurave. Të ardhurat nga investimet në vitin 2020 arritën 290 milionë denarë, gjegjësisht 17,1% nga të ardhurat e realizuara nga sigurimi

**GRAFIKU NR. 13:** Rezultati financiar nga veprimtaria e shoqërive të sigurimeve në (miliona denarë)



Burimi: AMS

#### 4.1.2.1. Rreziqe të sektorit të sigurimit

Në periudhën e ardhshme, shoqëritë e sigurimeve janë sfida të mundshme lidhur me të arkëtueshmet për dëme, si pasojë e **ritjes së aktivitetit dhe rreziqeve të ndryshimeve klimatike**. Pandemia uli përkohësisht shpenzimet e dëmeve të sigurimit jo-jetë në vitin 2020, gjë që mund të shpjegohet me masat mbrojtëse të vendosura me kufizime të lëvizjes dhe vëllimit të zvogëluar të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, në vitin 2021, me rimëkëmbjen e ekonomisë, siç pritej, numri i ngjarjeve të rrezikshme u rrit. Në afat të mesëm, kërcënim potencial janë paraqitjet e shpeshta të fatkeqësive natyrore, që e thekson ekspozimin e sektorit të sigurimit ndaj rreziqeve klimatike.

**Presionet mbi profitabilitetin e shoqërive të sigurimit janë të mundshme nga normat e ulëta të interesit, që reflektohet mbi të ardhurat nga investimet financiare.** Sektori vendor i sigurimeve tradicionalisht aplikon një strategji investimi konservatore me pjesëmarrje kryesore të investimeve në letrat shtetërore me vlerë dhe në depozitat bankare. Ekspozimi ndaj tregjeve financiare ndërkombëtare është shumë i ulët te shoqëritë e sigurimit jo-jetë, ndërsa te shoqëritë e sigurimit të jetës nuk kanë pothuajse asnjë investim në instrumentet e huaja financiare. Kjo lloj strukture investimi kontribuon në stabilitetin e sektorit, pasi siguron mbrojtje ndaj rreziqeve që lidhen me paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare. Nga ana tjetër, investimi në instrumente me rrezik të ulët i kufizon mundësitë për realizimin e të ardhurave adekuate nga investimi, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në mjedisin aktual të normave të ulëta të interesit. Së këndejmi, në periudhën e ardhshme, është i mundur një kërkim i rritur për të ardhurat nga kompanitë e sigurimit dhe një ribalancim i portofolit në drejtim të marrjes përsipër të rrezikut më të madh, veçanërisht nëse epoka e normave të ulëta të interesit mbijeton për një periudhë më të gjatë. Lëvizje të caktuara në këtë drejtim tashmë janë të pranishme në vitet e fundit përmes rritjes së pjesëmarrjes së investimeve në pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në letra pronësore me vlerë, që është më shumë tendencë e sigurimit jo-jetë. Por, megjithatë, nëse tendencat e tilla vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme, është e mundur ta rrisin ekspozimin e shoqërive të sigurimit ndaj rrezikut të tregut dhe të likuiditetit, gjë që thekson rëndësinë e menaxhimit adekuat me rreziqet dhe mbajtjes së tyre brenda kornizave të kontrolluara

Në përgjithësi, **në kushte të normave të ulëta të interesit, sigurimi i jetës bëhet më i shtrenjtë**. Nën supozimin se gjithçka tjetër është e pandryshuar Duke pasur parasysh se të gjitha të tjerat janë të barabarta, detyrimet e kompanive të sigurimit të jetës sipas policave të njëjta të sigurimit të jetës që kanë garantuar shumat e siguruara të dakorduara u bënë më të mëdha në krahasim me kushtet kur normat e interesit ishin më të larta. Kjo është ashtu, për shkak se gjatë vlerësimit të detyrimeve tani duhet të përdoren norma më të ulëta interesi që ndikon në rritjen pagesave të ardhshme të pritura të skontuara me para të gatshme të policave.

Këto detyrime janë në fakt përmbledhje e rezervës matematikore për çdo kontratë individuale aktive të sigurimit të jetës dhe ndryshimi i këtyre detyrimeve gjatë periudhës është zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve në bilancin e suksesit të shoqërive të sigurimit të jetës.

Sa e madhe është rëndësia e normave të interesit mund të shihet nëse analizohen sipas segmenteve bilancet vjetore të suksesit të shoqërive të sigurimit të jetës. Fitimet e realizuara janë pikërisht për shkak të të ardhurave nga investimet e fondeve, përkatësisht segmentit joteknik të bilancit të suksesit. Rezultati teknik, i cili në thelb përbëhet nga dallimi ndërmjet të ardhurave nga primet dhe shpenzimet nga rritja e rezervës/provigjonit matematik, është negativ.

**Projeksionet për rritjen e ekonomisë globale vijnë të shoqërohen me pasiguri të jashtëzakonshme<sup>7</sup>** lidhur me zhvillimin e mëtutjeshëm të pandemisë, e nga fillimi i vitit 2022 me tensionet gjeopolitike dhe lidhjet ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës. Kjo do të kontribuojë për përkeqësimin e mëtejshëm në zinxhirët e furnizimit, rritjen e inflacionit dhe pritjet e inflacionit dhe gjithashtu edhe për ashpërsimin më të hershëm dhe më të ashpër të politikave monetare në shumë ekonomi. Rrjedhimisht, këta faktorë mund të rrisin edhe rrezikun e stresit financiar, duke pasur parasysh cenueshmërinë e sektorit publik dhe privat, veçanërisht në vendet me rritje të shpejtë me borxhe të larta dhe vendet në zhvillim, dhe përveç kësaj, pasojat e mundshme që lidhen me ndryshimet klimatike do të kishin një efekt negativ në rimëkëmbjen e këtij grupi vendesh. Aktualisht, rrezik më i theksuar për ekonominë globale është përshkallëzimi i konfliktit ruso-ukrainas, i cili mund të shkaktojë rritje të çmimeve të energjisë primare dhe produkteve joenergjetike, destabilizimin e flukseve të tregtisë globale dhe rritje të paqëndrueshmërisë në tregjet financiare, duke u reflektuar në inflacionin global dhe rimëkëmbjen ekonomike globale.

Në afat të gjatë, ekonomia globale përballet me rrezikun e rënies më të theksuar të nxitësve kryesorë të rritjes, veçanërisht e theksuar në ekonominë me rritje të shpejtë dhe në zhvillim, në kushte të investimeve në mjete themelore, si dhe pasojat në kapitalin njerëzor me akses të kufizuar në arsim dhe shërbime shëndetësore. Rreziqet tjera globale përfaqësojnë rritjen e mundshme më të ngadaltë të ekonomisë kineze dhe shfaqjen e mundshme të trazirave sociale në korniza globale. Nga ana tjetër, rreziqet në rritje për rritjen e ardhshme lidhen kryesisht me mbështetjen fiskale shtesë në ekonominë e zhvilluara dhe përvetësimin më të shpejtë të teknologjive të reja, të cilat mund të çojnë në rritjen e produktivitetit dhe rimëkëmbje më të fuqishme ekonomike globale sesa që është paraparë.

---

<sup>7</sup> Raporti vjetor për vitin 2021 Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

### 4.1.3. Indikatorë të sektorit të sigurimeve

Indikatorët në veprimtarinë e sigurimeve përdoren për ndjekje më të mirë të aktivitetit të shoqërive të sigurimeve.

**Koeficienti i dëmeve** llogaritet si raport midis dëmeve të ndodhura në këtë periudhë dhe primit, **kurse koeficienti i shpenzimeve** paraqet raportin midis shpenzimeve për realizimin e sigurimit dhe primit. Mbledhja e këtyre dy koeficienteve e jep **koeficientin e kombinuar**. Më hollësisht, sipas grupeve të sigurimit në tabelën nr. 15 janë dhënë koeficientet me bazë bruto dhe bazë neto, përkatësisht pas izolimit të efektit të risigurimit.

**TABELA NR. 23:** Koeficientet teknike

	2021			2020		
	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar
<b>Neto koeficient</b>						
Jo-jetë	53,33%	52,15%	105,48%	47,82%	51,41%	99,23%
Jetë	79,44%	29,42%	108,86%	76,99%	28,98%	105,96%
<b>Gjithsej</b>	<b>59,13%</b>	<b>47,10%</b>	<b>106,23%</b>	<b>53,77%</b>	<b>46,83%</b>	<b>100,60%</b>
<b>Bruto koeficient</b>						
Jo-jetë	51,94%	45,46%	97,40%	50,09%	45,16%	95,25%
Jetë	78,94%	28,98%	107,92%	75,33%	28,87%	104,20%
<b>Gjithsej</b>	<b>56,92%</b>	<b>42,42%</b>	<b>99,34%</b>	<b>54,43%</b>	<b>42,36%</b>	<b>96,79%</b>

Burimi: AMS

**Risigurimi** ka rol të rëndësishëm në menaxhimin me rreziqe të marrë përsipër në sigurim. Indikatorët financiarë sugjerojnë se shoqëritë e sigurimeve që ushtrojnë aktivitete të grupit të sigurimeve jo-jetë bartin rrezik të konsiderueshëm në risigurim, për dallim nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitete të sigurimit të jetës. Kjo është e dukshme edhe nga tabela e sipërme në të cilën janë paraqitur koeficientet teknike bruto dhe neto nga risigurimi, veçmas për jo-jetë dhe jetë.

Vetëm një ngjarje e dëmshme e padëshiruar mund të shkaktojë pasoja negative për rezultatin financiar të një shoqërie të sigurimit, nëse nuk ka risigurim. Në aksidentet në komunikacion të autobusëve të cilët fatkeqësisht, përfunduan me shumë viktima njerëzore, rrëzimi i helikopterit në aeroportin e Shkupit, fatmirësisht pa viktima njerëzore, por me humbje të madhe materiale, dhe ngjarje të tjera që shkaktuan humbje të mëdha, nuk do të mjaftonin burimet ekzistuese të mjeteve me të cilat disponojnë shoqëritë e sigurimit, po të mos kishin siguruar të njëjtit mbulim adekuat të risigurimit.

Bilanci i përgjithshëm i suksesit të shoqërive së sigurimeve jo-jetë për vitin 2021, ngjashëm si edhe për vitin paraprak tregon se pjesa e të ardhurave vjetore themelore të shoqërive, nga bruto primit, të transferuar në risigurimin është afro 23% (2020: 22%), ose në shumë absolute, shoqëritë kanë transferuar 2,064 miliarda denarë (2020: 1,90 miliarda denarë) nga të ardhurat e realizuara bruto nga primit në vlerë prej 9,12 miliarda denarësh (2020: 8,47 miliarda denarë), në risigurim. Analizuar sipas shoqërive të veçanta, ekzistojnë dallime të mëdha në pjesëmarrjen relative të risigurimit në të ardhurat e realizuara bruto, dhe kështu te disa shoqëri të sigurimeve kjo përqindje në të ardhurat e përgjithshme vjetore të primeve është 30% në rast të fundit dhe 53%, ndërsa te shoqëri të tjera, përkatësisht ata në bazë të kompensimit të dëmeve dhe shpenzimeve operative. Kompensimi i përgjithshëm vjetor i

risiguruesve në dëmet në vitin 2021 është 988,97 milionë denarë (2020: 1,111 miliarda denarë). Të ardhurat e përgjithshme vjetore nga komisionet e shoqërive të sigurimeve është 496,36 milionë denarë (2020: 460,04 milionë denarë), që paraqet 24% (2020: 24%) të primeve të cilat shoqëritë i kanë paguar ndaj risiguruesve. Efekti financiar neto nga risigurimi mbi bilancin e përgjithshëm të suksesit për vitin 2021 është negativ dhe është 578,85 milionë denarë (2020: -336,28 milionë denarë)

Nëse analizohet pjesëmarrja e risigurimit në provigjonet e përgjithshme teknike bruto përmes bilancit të agreguar të gjendjes së shoqërive të sigurimit jo-jetë, më datë 31.12.2021 shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike e transferuar në risigurimin është 2.04 miliarda denarë (31.12.2020: 1,59 miliarda denarë), që paraqet 21% (2020: 18%) nga bruto shuma e rezervave apo provigjoneve teknike, që është 9,81 miliardë denarë (31.12.2020: 8,73 miliardë denarë).

**Norma e kthimit të investimeve (ROI)** llogaritet si raport i të ardhurave të zvogëluara me shpenzimet e investimeve dhe shumën e investimeve. Norma e kthimit të investimeve në nivel të industrisë për vitin 2021 është 3,61% që shënon rritje lidhur me vitin e kaluar (2020: 2,96%). Individualisht, sipas grupeve të sigurimit, vërejmë se norma e kthimit të investimeve të sigurimit jo-jetë në vitin 2021 është 2.90%, përkundërt 2.42% të realizuara në vitin 2020, kurse të sigurimit i jetës në vitin 2021 kjo normë është 4,55% që përbën ulje në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 3,69%.

**Norma e kthimit të fondeve (ROA)** llogaritet si raport i fitimit neto dhe fondeve të përgjithshme. Në nivel të industrisë ky indikator është 0,47 % që do të thotë ulje në krahasim me vitin e kaluar kur ka qenë 1.76%. Veçmas, sipas grupeve të sigurimit, norma e kthimit nga fondet të sigurimit jo-jetë në vitin 2021 është -0,30% përkundërt 1,67% në vitin 2020, kurse të sigurimit i jetës në vitin 2021 është 1,79% në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 1.92%.

**Norma e kthimit nga kapitali (ROE)** llogaritet si raport i fitimit neto dhe kategorisë kapital dhe rezerva. Në nivel të industrisë ky indikator është 1,65% përkundërt 5,99% në vitin 2020. Veçmas, sipas grupeve të sigurimit, norma e kthimit të kapitalit të sigurimit jo-jetë në vitin 2021 është -0,87% që paraqet rritje në raport me vitin e kaluar kur ka qenë -4,76%, kurse të sigurimit i jetës në vitin 2021 është 9,63% që paraqet ulje të vogël në krahasim me vitin 2020 kur ka qenë 10,13%.

**Koeficienti i borxhit** llogaritet si raport i obligimeve të përgjithshme dhe fondeve të përgjithshme. Ky koeficient dëshmon se sa prej fondeve janë financuar nga obligimet (provigjonet teknike dhe obligimet e tjera) pa u përfshirë kapitali dhe rezervat ligjore. Në vitin 2020 ky koeficient ka qenë 71,75%, që përbën rritje të vogël në raport me vitin 2020 kur ka qenë 70.64%.

Pasqyra e të gjithë këtyre indikatorëve financiarë është dhënë në Tabelën nr. 24

**TABELA NR. 24:** Indikatorë financiare

	2021				2020			
	ROI	ROA	ROE	Borxhi	ROI	ROA	ROE	Borxhi
<b>Jo-Jetë</b>	2,90%	-0,30%	-0,87%	66,15%	2,42%	1,67%	4,74%	64,77%
<b>Jetë</b>	4,55%	1,79%	9,63%	81,46%	3,69%	1,92%	10,13%	80,66%
<b>Gjithsej</b>	<b>3,61%</b>	<b>0,47%</b>	<b>1,65%</b>	<b>71,75%</b>	<b>2,96%</b>	<b>1,76%</b>	<b>5,99%</b>	<b>70,64%</b>

Burimi: AMS

## 4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME

Roli i ndërmjetësimit në shitje ka ndikim gjithnjë dhe më të madh në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2021 43,14% (2020: 43,49%) e PSHB-së së realizuar është realizuar nëpërmjet shitjes së drejtpërdrejtë nga shoqëritë e sigurimeve, kurse 56,86% (2020: 56,51%) janë realizuar nga kanalet indirekte të ndërmjetësimit (Tabela nr. 18).

**TABELA NR. 25:** Struktura e kanaleve të shitjes së policave sipas PSHB-së të realizuar (mijëra denarë)

	Jo-jetë				Jetë				Gjithsej			
	2021		2020		2021		2020		2021		2020	
	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	Pjesëmarrja
Shitja e drejtpërdrejtë	4.584.193	48%	4.021.505	48%	433.187	22%	356.156	20%	5.017.380	43%	4.377.661	43%
Shoqëritë e brokerimit në sigurime	2.937.866	31%	2.431.315	29%	863.324	43%	806.446	46%	3.801.190	33%	3.237.761	32%
Shoqëritë për përfaqësim në sigurim	685.633	7%	634.602	8%	214.775	11%	205.328	12%	900.408	8%	839.930	8%
Agjencitë turistike	13.773	0%	9.015	0%					13.773	0%	9.015	0%
Sallon automobilash	14.805	0%	12.425	0%					14.805	0%	12.425	0%
Banka	205.923	2%	169.893	2%	308.664	15%	223.538	13%	514.587	4%	393.431	4%
Përfaqësues	1.158.741	12%	1.025.945	12%	181.811	9%	149.022	9%	1.340.552	12%	1.174.967	12%
Kanalet e tjera të shpërndarjes	26.999	0%	20.700	0%					26.999	0%	20.700	0%
Gjithsej	9.627.933	100%	8.325.400	100%	2.001.761	100%	1.740.490	100%	11.629.694	100%	10.065.890	100%

*Burimi: AMS*

Në strukturën e kanaleve të shitjes për sigurimet jo-jetë, pjesëmarrje më të madhe zuri shitja direkte me 47,61%, pastaj vijon shitja nëpërmjet shoqërive të brokerimit të sigurimeve me 30,51%, shitjet përmes përfaqësuesve (persona fizikë) me 12,04%, shitjet përmes shoqërive për përfaqësim në sigurimet me 7,12%, bankat me 2,14% dhe 0,58% përmes kanaleve të tjera të shpërndarjes. Ndërsa, në strukturën e kanaleve të shitjes së sigurimeve të jetës te sigurimi i jetës, pjesëmarrje më të madhe zënë shoqëritë e brokerimit të sigurimeve me 43,13%, pastaj vijojnë shitja direkte me 21,64%, bankat me 15,42%, shitjet përmes shoqërive për përfaqësim në sigurime me 7,62% dhe 9,08% shitje përmes përfaqësuesve (personave fizikë).

### 4.2.1. Përfaqësimi në sigurime

Përfaqësimi në sigurime paraqet përgatitje dhe lidhje të marrëveshjeve për sigurim në emër dhe për llogari të një apo më shumë shoqërive të sigurimeve, për prodhimet e sigurimit të cilat nuk janë konkurrencë midis tyre. Përfaqësimi në tregun e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet nëpërmjet përfaqësuesve në sigurime – persona fizikë, shoqërive për përfaqësim në sigurime dhe bankave të cilat kanë marrë leje për ushtrimin e aktiviteteve për përfaqësim në sigurime. Nëpërmjet këtyre kanaleve në vitin 2021 janë realizuar 23,69% të PSHB-së (2020: 23,93%), përkatësisht 2,41 miliarda denarë (2020: 2,41 miliardë denarë) që përfaqëson rritje prej 14,42% në raport të vitit të kaluar.

Përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë kryhet në bazë të licencës së AMS-së e cila merret pas dhënies paraprake të provimit për ushtrimin e aktivitetit për përfaqësim në sigurim. Në PSHB-në e përgjithshme përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë merr pjesë me 11.53%, me ç'rast në vitin 2021 numri i përfaqësuesve që kanë pasur licencë nga AMS është 1.313.


Numri i shoqërive të përfaqësimit në sigurime në raport me vitin 2020 është rritur për dy shoqëri të reja (SHPS Pro-Ins SHA Shkup dhe SHPS Protektor SHA Prilep), duke e bërë numrin e përgjithshëm të shoqërive përfaqësuese 12. Në totalin e PSHB-së, shoqëritë përfaqësuese në sigurimin në vitin 2021 marrin pjesë me 900,41 milionë denarë ose 7,74% nga totali i ndërmjetësimit dhe në krahasim me vitin e kaluar është shënuar rritje prej 7,20% në vitin (2020: 839,93 milionë denarë).

Gjithashtu, përfaqësim në sigurime mund të kryejë edhe banka e cila ka marrë leje për ushtrimin e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa me pëlqim paraprak nga AMS-ja. Numri i bankave që ushtrojnë aktivitete të përfaqësimit në sigurim në vitin 2021 mbeti i pandryshuar përkatësisht 7 banka. Bankat morën pjesë me 514,59 milionë denarë ose 4,42% në PSHB-në e përgjithshme që paraqet ulje prej 30,79% në raport me vitin 2020 (2020: 393,43 milionë denarë).

Gjatë vitit 2021 përmes shoqërive të përfaqësimit në sigurim janë lidhur 85,007 marrëveshje për sigurim (polica) (2021: 71.165) që është më shumë për 19,45% në krahasim me vitin paraprak. Përmes bankave, në vitin 2021 janë lidhur 187.127 marrëveshje për sigurim (2020: 147.073) që paraqet rritje prej 27,23% në krahasim me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme sipas klasave të sigurimit, ndërsa e realizuar nga shoqëritë për përfaqësim dhe bankat është paraqitur në Grafikon nr. 14.

**GRAFIKU NR. 14:** Struktura e PSHB-së. sipas klasave të sigurimeve



Burimi: AMS

#### 4.2.1. Veprimtari brokerimi në sigurime


Veprimtaritë e brokerimit në sigurime nënkuptojnë ndërmjetësim në dakordimin e mbulimit të sigurimit dhe risigurimit, si dhe gjatë realizimit të kërkesave të dëmshpërblimit pas ndodhjes së ngjarjes dëmtuese të siguruar te shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, në emër dhe në llogari të klientëve. Nëpërmjet këtij kanali të shpërndarjes shoqëritë për veprimtari brokerimi në sigurime në vitin 2021 kanë realizuar 32,69% të PSHB-së (2020: 32,17%), përkatësisht 3,80 miliardë denarë (2020: 3,24 miliardë denarë) që përbën rritje prej 17,40% në raport me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2021 në tregun e sigurimit vepruan 39 shoqëri brokerimi në sigurime. Gjatë vitit 2021 është hequr leja e Shoqërisë së Brokerimit në Sigurime AMG Premium SHA Shkup.

Në këtë periudhë shoqëritë e brokerimit në sigurime kanë realizuar shitje të 405.595 policave (2020: 306.693) që paraqet rritje prej 32,25% krahasuar me vitin paraprak.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme sipas klasave të sigurimit e realizuar nga shoqëritë e brokerimit në sigurime, është paraqitur në grafikun nr. 15.

**GRAFIKU NR. 15:** Struktura e PSHB-së sipas klasave të sigurimit



Burimi:AMS

#### 4.1. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE

Në përputhje me Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport, Byroja Nationale e Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm. "BNS") ushtron aktivitetet e parapara me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike nga përgjegjësia në qarkullim (kartoni i gjelbër) dhe i përfaqëson shoqëritë e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të sigurimeve. BNS-ja lëshon dhe shtyp kartona jeshilë ndërkombëtarë për nevojat e anëtarëve, mban evidencë statistikore dhe kryen përpunim statistikor të të dhënave statistikore të shoqërive të sigurimeve, vendos dhe mban sistem qendror për evidencën e policave dhe dëmeve nga përdorimi i mjeteve motorike.

BNS-ja është anëtare e Këshillit të Byrove në Bruksel që nga viti 1994, që ka për qëllim të lehtësojë qarkullimin rrugor ndërkombëtar të mjeteve motorike dhe atyre shoqëruese, nëpërmjet sigurimit nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara nga persona të tretë, sipas kushteve të cilat janë përcaktuar në vendin e vizituar dhe garanton se personave të dëmtuar në rast të fatkeqësisë rrugore do t'u kompensohet dëmi i shkaktuar me përdorim të mjetit motorik me zbatim të legjislacionit kombëtar të atij vendi. Njëkohësisht, si anëtare e Këshillit, BNS-ja merr pjesë në punën e Grupit Evropian Juglindor ku marrin pjesë vendet nga rajoni.

Në BNS janë anëtare njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh, përkatësisht të gjitha shoqëritë për sigurim jonetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në raportin për punën të cilin BNS-ja e dorëzoi në AMS, në përputhje me nenin 54 paragrafi (3) të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Qarkullim, është paraqitur puna financiare e BNS-së dhe puna financiare e Fondit Garantues për vitin 2020.

Me bilancin e 31.12.2021 fondet e përgjithshme të BNS-së arritën vlerën 302,86 milionë denarë prej të cilave 231,10 milionë janë fondet aktuale, kurse 71,76 milionë të tjera lidhen me fondet joaktuale dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë ulje prej 4.77%. Në fondet e përgjithshme të BNS-së pjesëmarrje më të madhe prej 54,81% zënë depozitat në banka, pastaj vijojnë të arkëtueshmet e shoqërive të sigurimeve me 33.00% dhe investimet në letrat me vlerë me 6.82%. Në obligimet dhe kapitalin e përgjithshëm të BNS-së në vitin 2021, kapitali merr pjesë me 63,12%, kurse obligimet me 36,73%. Në vitin 2021 BNS-ja ka realizuar fitim në shumë prej 22,34 miliardë denarësh (viti 2020: fitim prej 2,61 miliardë denarësh).

#### 4.1.1. Fondi Garantues i BNS-së

BNS-ja, në përputhje me nenin 58 të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Transport, formon Fond Garantues i cili shërben për pagim të:

1. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete motorike dhe rimorkio të panjohura dhe të pasiguruara, barka dhe anije me fuqi motorike të pasiguruara si dhe mjete fluturuese të pasiguruara;
2. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete të transportit të regjistruara për transport të udhëtarëve në qarkullimin publik për të cilat pronarët nuk kanë bërë marrëveshje sigurimi të udhëtarëve nga pasojat e fatkeqësisë - aksidentit;
3. dëmeve nga sigurimet e obligueshme për të cilat personat e dëmtuar nuk mund t'i marrin pagesat për shkak të ndërprerjes së punës së shoqërisë së sigurimeve me të cilën është bërë marrëveshje për sigurim, ku paguhet vetëm ajo pjesë e dëmit i cili nuk është kompensuar nga masa e falimentimit të shoqërisë së sigurimeve; dhe
4. dëmeve nga mjetet motorike të siguruara të cilat kanë prejardhje nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilat në përputhje me Marrëveshjen e Kretës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i garanton Byroja Nacionale e Sigurimeve.

Puna e Fondit Garantues bazohet në Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport si dhe Rregulloren për formim dhe përdorim të Fondit Garantues dhe Udhëzimin për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e pagesës së mjeteve nga Fondi Garantues, të miratuar nga BNS-ja.

**TABELA NR. 26:** Pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimit për periudhën 1.1.2021-31.12.2021 (mijë denarë)

Emri i shoqërisë së sigurimeve	PSHB-ja e përgjithshme për të gjitha sigurimet e obligueshme	% pjesëmarrja në PSHB për të gjitha sigurimet e obligueshme	Pjesëmarrje në Fondin Garantues
Maqedonia	249.398.022	5,19%	9.596.889
Trigllav	522.101.898	10,86%	20.090.591
Euroins	389.552.878	8,11%	14.990.077
Sava	438.927.833	9,14%	16.890.036
Viner	613.950.463	12,78%	23.624.943
Eurolink	386.556.796	8,05%	14.874.787
Grave Jo-Jetë	295.813.113	6,16%	11.382.951
Unika	620.265.581	12,91%	23.867.951
Osiguritelna polisa	445.425.587	9,27%	17.140.071
Halk	477.804.245	9,95%	18.386.008
Kroacia Jo-Jetë	364.777.011	7,59%	14.036.696
<b>Gjithsej</b>	<b>4.804.573.427</b>	<b>100,00%</b>	<b>184.881.000</b>

*Burimi: Raporti i punës i BNS-së për vitin 2020*

Shoqëritë e sigurimeve të cilat ushtrojnë aktivitete të obligueshme të sigurimeve nga autopërgjegjësia janë të detyruara të paguajnë mjete në Fondin Garantues në shumë proporcionale me primin e

realizuar sipas klasave të veçanta të sigurimit të obligueshëm nga autopërgjegjësia në tremujorin paraprak, për tremujorin vijues gjatë vitit aktual.

Në përputhje me vendimin e Bordit Drejtues të BNS-së çdo vit kalendarik kryhet shpërndarje e re e mjeteve të Fondit Garantues në vlerë prej 3,000,000 eurosh, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së shoqërisë së sigurimeve në primin e përgjithshëm të shkruar për të gjitha sigurimet e obligueshme. Për vitin 2021 pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimeve është dhënë në Tabelën nr. 26.

### 4.3.2. Rimbursimi i dëmeve nga Fondi Garantues

Në përputhje me nenin 60 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurime të Detyruara në Transport, shoqëria e sigurimeve që ka kryer përpilim dhe pagesë të kërkesës për kompensim të dëmit ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara nga mjetet e Fondit Garantues.

Nga mjetet e Fondit Garantues nuk kompensohen dëmet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike të huaja të pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse për të cilat vlejné marrëveshjet e veçanta ndërkombëtare në të cilat nënshkruese është Republika e Maqedonisë së Veriut

**TABELA NR. 27:** Dëme të raportuara dhe të pranuar për rimbursim të Fondit Garantues për periudhën 1.1.2021- 31.12.2021

Emri i shoqërisë së sigurimeve	Numri i dëmeve të raportuara për rimbursim	Numri i dëmeve të pranuar në Fondin Garantues	Dëme të pranuar në Fondin Garantues (dëme+gjendje) shuma në denarë
Maqedonia	72	72	22.930.548
Trigllav	55	55	7.717.449
Euroins	76	76	13.434.796
Sava	54	54	9.118.078
Viner	98	98	12.640.043
Eurolink	57	57	12.017.755
Grave Jo-Jetë	62	60	26.192.870
Unika	84	83	14.660.411
Osiguritelna polisa	67	67	12.884.540
Halk	70	69	8.263.430
Kroacia Jo-Jetë	52	52	10.871.382
<b>Gjithsej</b>	<b>747</b>	<b>743</b>	<b>150.731.302</b>

*Burimi: Raporti i punës i BNS-së për vitin 2020*

Në vitin 2020 në BNS nga shoqëritë e sigurimeve janë raportuar 747 dëme për rimbursim, nga të cilat 743 dëme në shumë prej 150,73 milionë denarësh janë pranuar dhe janë rimbursuar.

Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim në Fondin Garantues në vitin 2021 (747) është zvogëluar për 22 dëme në krahasim me vitin 2020 (769), përkatësisht shënon ulje prej 52,95%.

Dëmi mesatar i paguar në vitin 2021 është 195.154 denarë dhe ai shënon rritje prej 2,65% në raport me dëmin mesatar të paguar në vitin 2020.

Numri i dëmeve të raportuara dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi Garantues gjatë vitit 2020, si dhe shuma e dëmeve të pranuar janë dhënë në Tabelën nr. 27

Numri 01-443/1  
Shkup, 23.6.2022

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve,  
Kërste Shajnoski